



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:022925

Datë: 20.11.2023

Numri i dokumentit: 04943778

PKR.nr.989/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Krime të Rënda, me kryetaren e trupit gjykues – gjyqtaren gjykuese Fatime Dërmaku dhe anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët Kushtrim Shyti dhe Gazmend Bahtiri, me zyrtaren ligjore Tringë Zogaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R.B, për veprën penale Konflikt i interesit nga neni 417 par.1, 3 dhe 4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.22K/20, të datës 30.10.2020, në shqyrtimin gjyqësor publik të mbajtur me datë 19.09.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit Bukurije Gjonbalaj, të pandehurit R.B me mbrojtësin sipas autorizimit av. F.S, me datë 20.09.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 20.11.2023, e përpilojë me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akukuzari:

R.B, nga i ati ... dhe nëna ..., e gjinisë ..., i lindur me ..., në ..., ku edhe tani jeton në rrugën ..., me numër personal ..., ka të kryer ..., punon në ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim ka qenë nga data 13.02.2020 deri më datë 13.03.2020, ndërsa, në arrest shtëpiak nga data 13.03.2020 deri më datë 13.05.2020,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse, i pandehuri R.B,

Në cilësinë e personit zyrtar, Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të NPK "Trafiku Urban" në Prishtinë, me dashje merr pjesë personalisht në çështjen zyrtare ku e ka ditur se bëhet fjalë për bashkëshorten e tij L.B, kështu që ka ushtruar autoritetin zyrtar duke i rekomanduar dhe këshilluar në vazhdimësi, nga muaji shtator e deri në muajin dhjetor të vitit 2019, ka kërkuar nga vartësi i tij tani i dëmtuari L.R, i cili kishte pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në ndërmarrjen e lartcekur, përmes komunikimeve verbale dhe elektronike. e veçanërisht përmes sms-ve në "WhatsApp". ashtu që i dëmtuari t'ia punësojë bashkëshorten e të pandehurit L.B në këtë ndërmarrje, ku ishte e angazhuar si praktikante nga ana e Entit për Punësim, fillimisht ka kërkuar që të hapet konkursi për pozitën e Zyrtarit të IT e pas shpalljes së konkursit, ka insistuar dhe drejtuar kanosje që bashkëshortja e tij të punësohet në konkursin e lartcekur, e kur i dëmtuari me datë 23.12.2019, ka marrë vendim për anulimin e konkursit, i pandehuri ka filluar iniciativën për shkarkimin e tij duke e bërë gati draftin e vendimit për shkarkimin e tij si dhe është kanosur se do e rrah të dëmtuarin,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale Konflikt i interesit nga neni 417 par.1, 3 dhe 4 të KPRK-së

-Pala e dëmtuar: L.R, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

-Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë buxhetore të Gjykatës.

A R S Y E T I M I

1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, me datë 30.10.2020, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.22K/20, në çështjen penale ndaj të akuzuarit R.B, për veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 të KPRK-së, e të cilën vepër në fjalën përfundimtare e ka ri cilësuar si vepër penale të Konfliktit të interesit nga neni 417 par.1, 3 dhe 4 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar, të mbajtur me datë 28.01.2022, i akuzuari është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale me të cilën është ngarkuar, andaj është udhëzuar për të drejtën e tij për parashtrim të kundërshtimit të provave dhe paraqitjes së kërkesës për hedhje të aktakuzës. I pandehuri përmes avokatit mbrojtës të tij, brenda afatit ligjor kanë parashtruar kërkesë për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimet e provave, mirëpo Gjykata me aktvendimin PKR.nr.989/2020, të datës 18.03.202, e ka refuzuar kërkesën e mbrojtësit të të pandehurit për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtimet e provave.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor në datat: 27.03.2023, 15.05.2023 dhe datë 19.09.2023, ku është dhënë fjala përfundimtare e palëve, ndërsa prezent kanë qenë Prokurori i Shtetit Bukuriqe Gjonbalaj, i pandehuri R.B me mbrojtësin sipas autorizimit av. F.S.

Shpallja e aktgjykimit është bërë me datë 20.09.2023.

Pas administrimit të provave, Prokurori i Shtetit Bukuriqe Gjonbalaj, në fjalën përfundimtare deklaruar se, fillimisht në fjalën përfundimtare të këtij shqyrtimi gjyqësor bën rikualifikimin nga vepra penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së në veprën penale Konflikt i interesit nga neni 417 par.1, 3 dhe 4 të KPRK-së. Gjithashtu, bën edhe precizimin e dispozitivit të aktakuzës ashtu që në rreshtin e parë deri në rreshtin e dytë të fjala “Prishtinë” duhet të hiqet “me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete apo personin tjetër duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar ka tejkaluar kompetencat e tij” dhe duhet të shtohet “me dashje merr pjesë personalisht në çështjen zyrtare ku e ka ditur se bëhet fjalë për bashkëshorten e tij L.B, kështu që ka ushtruar autoritetin zyrtar duke i rekomanduar dhe këshilluar në vazhdimësi” dhe vazhdon ashtu siç është, dhe kjo pasi me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale Konflikti i interesit. Elementet e kësaj vepre penale ekzistojnë sepse i pandehuri ka qenë person zyrtar, bashkëshortja e tij ka qenë L.B e cila ka qenë e punësuar në NPK Trafiku Urban në Prishtinë, dhe se i njëjti ka ushtruar autoritetin e tij zyrtar tek i dëmtuari L.R duke rekomanduar dhe këshilluar dhe kërcënuar që të hapë konkurs dhe atë në kohë sa më të shkurtër për punësimin e bashkëshortes së tij gjë që vërtetohet edhe me deklaratën e të dëmtuarit L.R i cili në deklaratën e dhënë në polici, Prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se i pandehuri si person zyrtar-kryesues i bordit të drejtorëve në Trafikun Urban e ka rekomanduar, kanosur dhe këshilluar që të hapë konkurs për të cilin konkurs i ka premtuar edhe propozim për rritjen e rrogave, mirëpo

në momentin kur i njëjti konkurs është anuluar nga ana e të dëmtuarit L.R i pandehuri i revoltuar ka thënë që nuk do ta mbrojë propozimin për rritjen e pagave, njëherit ka kërkuar nga zyrtari F.T që të përpilojë draft vendimin për shkarkimin e të dëmtuarit. Përveç deklaratës së të dëmtuarit L.R, kjo vërtetohet edhe me deklarinimin e dëshmitarëve D.M, F.T, vërtetohet edhe nga deklarata e dëshmitares L.B e cila në atë kohë ka qenë e punësuar si praktikante në Trafikun Urban, nga deklarata e dëshmitares V.H, dëshmitari G.B dhe dëshmitarja V.A.H. Nga të gjitha këto dëshmi vërtetohet se në këtë ndërmarrje ka punuar si praktikante bashkëshortja e të pandehurit i cili ka kërkuar që të hapet konkurs dhe e njëjta të mbetet në punë në të njëjtën ndërmarrje me çka kjo paraqet konflikt interesi sepse me rastin e ushtrimit të autoritetit zyrtar i pandehuri personalisht ka marrë pjesë në këtë çështje. Përveç dëshmisë së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve kjo vërtetohet edhe nga provat materiale të administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ku vërehen bisedat dhe sms e dërguara nga i pandehuri tek i dëmtuari L.R nga i cili ka kërkuar që të hapet konkursi sa më shpejtë, afati ka qenë deri me datë 15.01.2020, duke i thënë se “e mira kthehet me të mirë”, mirëpo në momentin kur ka dëgjuar se konkursi i është anuluar dhe nuk kanë vepruar sipas rekomandimeve dhe këshillimeve të tij, është revoltuar duke përpiluar draftin e vendimit për shkarkimin e zyrtarit me çka i njëjti me këtë me dashje ka ushtruar autoritetin e tij zyrtar duke e dëmtuar të dëmtuarin në këtë rast L.R fillimisht që të sillet dhe të veprojë në kundërshtim me ligjin e pastaj duke e kërcënuar me vendim për shkarkim, kështu që konsideroj se nga këto veprime të të pandehurit të vërtetuara nga provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ndërsa mbrojtjen e të pandehurit gjykata ta hedhë poshtë dhe ta marrë si pretekst për t’i ikur përgjegjësisë penale për veprën penale për të cilën është akuzuar sepse mbrojtja e tillë është në kundërshtim me të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, kështu që i propozoj gjykatës që të akuzuarin R.B ta shpallë fajtor për veprën penale Konflikt i interesit nga neni 417 par.1, 3 dhe 4 të KPRK-së dhe me rastin e matjes së dënimit të marrë parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të parapara me ligj, ku si rrethanë rëndësuese të merret presioni i vazhdueshëm ndaj të dëmtuarit L.R, këmbëngulësia dhe dashja e tij për ta kryer këtë vepër penale, mënyrën e hakmarrjes për veprimet e të dëmtuarit L.R me rastin e anulimit të konkursit, ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese t’i marrë parasysh rrethanat lehtësuese të parapara me ligj.

Mbrojtësi i të pandehurit R.B, av. F.S, në fjalën përfundimtare, të cilën e ka dorëzuar në formë të shkruar, ka deklaruar, që nga fillimi i procedurës në këtë çështje penale ka qenë i bindur se në veprimet e të mbrojturit të tij nuk do të provohet kryerja e veprës penale për të cilën është akuzuar, e që kjo u vërtetua edhe pas administrimit të provave.

Përgjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe procedurës u vërtetuan përtej çdo dyshimi faktet, si në vijim:

Se i mbrojturi i tij R.B, nuk ka përfituar asgjë për veten e tij, nuk i ka mundur ndonjë përfitim askujt dhe nuk i ka shkaktuar dëm askujt. Është bërë mëse e qartë se Prokuroria nuk kishte asnjë provë se tek i mbrojturi i tij ekzistonte dashja me qëllim të dobisë për vete si dhe nuk kishte asnjë provë në bazë të cilave do ta vërtetonte faktin se ai kishte për qëllim që të përfitonte tjetri.

Është vërtetuar fakti se R.B nuk ka dashur asnjëherë të ndikoj apo t'i shkaktoj pasoja ndokujt madje as që ka kërkuar nga i dëmtuari L.R që ai si Kryeshef Ekzekutiv i TU t'i punësoj bashkëshorten e tij, fakt ky i vërtetuar edhe nga vet i dëmtuari gjatë dëshmisë së tij dhënë pranë kësaj gjykate gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor.

Është vërtetuar se R.B përveç raporteve zyrtare ka pasur edhe raporte të afërta shoqërore me të dëmtuarin/dëshmitarin L.R dhe të tjerët. Kjo është vërtetuar edhe nga vet L.R gjatë deklarimit të tij në këtë shqyrtim gjyqësor.

Është vërtetuar se R.B dhe L.R, në vazhdimësi kanë komunikuar në mënyrë shoqërore në zhargonin e komunikimit të përditshëm shoqëror përmes platformës sociale "WhatsApp", por kjo nuk do të thotë që në ka ekzistuar dashja për shkaktimin e veprës penale, por shkak është më shumë si pasojë e mentalitetit dhe formës si dhe zhargonit të komunikimit, siç ishte edhe komunikimi në mes tyre.

Ka theksuar se, këto keqinterpretime kanë qar në situata kur një vepër është trajtuar si penale edhe pse nuk është në fakt e asaj natyre por e natyrës Administrative, andaj edhe në këtë rast kemi të bëjmë me veprimet më tepër të natyrës administrative se sa penale.

Gjatë këtij gjykimi është vërtetuar fakti se bashkëshortja e të mbrojturit të tij, nuk është punësuar asnjëherë në Trafikun Urban dhe se e njëjta ende është e papunë.

Është vërtetuar se konkursi ku ajo ka aplikuar është anuluar me datën 23.12.2019, përmes shkresës me numër nr.4591nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE) L.R.

Është vërtetuar fakti se bashkëshortja e L.B, ka qenë e angazhuar në këtë ndërmarrje si praktikante (në pozitën punë praktike: Teknologji Informative) përmes Agjencisë për Punësim të Republikës së Kosovës, me kontratë me afat të caktuar, duke kaluar përmes vlerësimit të komisionit përzgjedhës si kandidatë e suksesshme me përgatitje Universitare në drejtimin përkatës.

Gjithashtu, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor dhe administrimit të provave është vërtetuar se, me datë 04.01.2020 L.B, është njoftuar përmes shkresës me numër nr.327 nga Kryeshefi Ekzekutiv (KE) L.R, për mos vazhdimin e kontratës së punës praktike.

Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor është vërtetuar se pretendimet e Prokurorisë së Shtetit ishin thellësisht të gabuara, pasi që në rastin konkret dhe hipotetik, edhe po të kishte kërkuar i mbrojturi i tij që t'i punësohet bashkëshortja e tij në Trafikun Urban, e që gjatë shqyrtimit është vërtetuar nga vet i dëmtuari L.R që, R.B, nuk ka kërkuar nga ai, prap nuk është vendosur siç kishte kërkuar i mbrojturi i tij.

Atëherë shtrohet pyetja se si i është shkaktuar dëm palës së dëmtuar? Mirëpo, edhe sikur të i jetë shkaktuar dëm eventual, organi administrativ nuk duhet të vendos bazuar në faktin nëse i shkaktohet dëm palës, mirëpo nëse është e mbështetur në ligj kërkesa e paraqitur nga pala, pavarësisht dëmeve apo dobive që shkakton apo siguron për palët vendimi i caktuar.

Një interpretim i tillë i dispozitave ligjore, qëllimi për të shkaktuar dëm apo dobi pasurore lidhet me mënyrën e vendosjes së organit administrativ, është i gabuar dhe i rrezikshëm pasi që e zgjeron përgjegjësinë penale duke i përfshirë brenda saj edhe veprimet apo shkeljet që lidhen me mënyrën e vendosjes, që mund të evitohet në procedurë administrative, përmes mjeteve juridike, ankesës apo padisë.

Gjatë këtij gjykimi është vërtetuar se hapja e konkursit nuk ka qenë si pasojë e kërkesës apo presionit të R.B, por ka qenë nevojë e Trafikut Urban dhe këtë e ka vërtetuar me deklaratën e të dëmtuarit L.R, të dhënë me datën 31.10.2022, i cili në përgjigjen e dhënë në pyetjen e mbrojtjes faqen 7 të procesverbalit është përgjigjur:

“Konkursin nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv, e kam hapur nga nevoja imediate që e kemi pas në ndërmarrje. Shpesh nuk kemi mundur te komunikojmë me emaila zyrtar dhe jemi dashur te komunikojmë me email private. Në publikimet ne webfaqe për transportin publik, mungonte

zyrtari përgjegjës me njohuri për këtë çështje, apo çështje të tjera të IT-së, si: instalimi i kompjuterëve, softwerëve brenda administratës. Konkursi është hap për shkak të nevojës”

Këtë e ka vërtetuar po ashtu edhe dëshmitari D.M në deklaratën e tij të dhënë me datën 15.02.2022 në faqen 6 në paragrafin e fundit të procesverbalit, i cili thotë, *Përgjigje*: “po , është e vërtet sepse kemi pasur nevojë për një zyrtar të IT-së” .

Po ashtu gjatë ballafaqimit me prova përkatësisht me emailin e datës 05.12.2019 të orës 15:28, është vërtetuar se Trafiku Urban, kishte nevojë për zyrtarë të IT, pasi që është kërkuar nga vet dëshmitari D.M, drejtuar KE L.R.

Gjithashtu, kjo vërtetohet edhe përmes përgjigjes që L.R i jep pyetjes së gjykatës: A ke qenë i detyruar për shpalljen e konkursit?, përgjigja ka qenë: jo.

Gjatë këtij gjykimi është vërtetuar fakti se përmes komunikimeve se L.R, është personi i cili ka insistuar në punësimin e bashkëshortes së të mbrojturit të tij, e jo i mbrojturi i tij R.B, pasi që i njëjti ka kërkuar nga R.B të mos merret me atë punë fare.

Ky fakt është vërtetuar përmes provës komunikimit të L.R me R.B në WhatsApp me datën 24.07.2019 ora 09:11 e 55 sekonda, si në vijim:

“ Na po vazhdojm me pune,puna flet vet. Flm për mbështetje, sa te kryej rastin do jme me marr L.B,..... ska çka ndodh, folët 2,3 dite dhe harrohet ajo punë” duke mos ju përzier në këtë çështje”.

Gjatë ballafaqimit të dëshmitarit L.R me emalin e datës 13.12.2019 në ora 13:58 dërguar ne adresë R.B, lidhur me takimin e mëngjesit në “NEST” në mes L.R dhe R.B dhe L.B, vërtetohet fakti se bisedat e këtij takimi janë keqkuptuar dhe keqinterpretuar nga L.R pasi që i njëjti ka deklaruar se në këtë situatë është ardhur nga pakujdesia e tij dhe se nuk ka pasur fare kërcënim nga R.B:

“Na ndodhi kjo çështje sot, tuj mendu për ma mirë dhe se unë kam folë sh lirë dhe pa protokoll në aspektin miqësor, për këtë temë nuk kisha pas qef me ditë D. dhe F., ju e gjykoni vet mirëpo e shoh te arsyeshme që të përmendi se keq kuptimet tona mos ti dijne ata. Qëllimi im ishte me bisedu që le të ndihet krenare dhe mos të ketë brenga se proceset zhvillohen por nga

pakujdesia ime.. është prodhuar efekti i kundërt dhe me vjen shumë keq për L.B se është nervozuar”

Ndërsa në pyetjen e mbrojtjes në faqen 7 dhe 8 të procesverbalit se: “Çka keni konsideruar si kërcenim ne rastin që e përmendet kur keni qëndruar ne kafeterinë NEST?” L.R është përgjigjur se: “Në raport me zotin R.B, meqë nuk i ndërhyri bashkëshortes së tij gjatë bisedës së saj, gjestikulimit me gisht të saj, unë e kam kthyer kryet nga R.B me pa opinionin e tij, dhe ai nuk ndërhyri dhe unë e konsiderova një aprovim të tij për reagimin e saj. Nga Zoti R.B nuk e kam marrë si kërcenim fizik por e kam marrë si humbje e vendit të punës por nga zonja L.B e kam kuptuar si kërcenim se mka bo me u ndi keq, me vrazhdësi të madhe, shikimi i saj ishte i tillë.

Është vërtetuar fakti se në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të datës 09.12.2019, është diskutuar sistemi i punëtorëve në Trafikut Urban për t’iu shmangur thyerjeve të zyrave por jo në kontekstin që pretendohet me aktakuzë të ketë thënë i mbrojturi im L.R, si në vijim:

“ për t’iu shmangur thyerjeve të zyrave për krijimin e hapësirave të reja nga zyra operative...” (procesverbali i datës 09.12.2019 faqe 5 paragrafi i fundit).

Kjo madje është vërtetuar edhe me komunikimin e L.R përmes WhatsApp te datës 12.06.2019, ku i dëmtuari dhe i mbrojturi i tij, diskutojnë për thyerjen e zyrave madje L.R i dërgon skicën R.B, për thyerjen dhe ndarjen e zyrave me knauf.

Gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor është vërtetuar fakti se L.R, nuk ka qenë në dijeni fare lidhur me një vendim-draft për shkarkimin e tij siç pretendon Prokuroria.

Në pyetjet e Prokurorit të Shtetit në faqe 9 të procesverbalit: “ gjatë kësaj kohe a e keni kuptuar se është marrë një vendim-draft për shkarkimin tuaj? është përgjigjur, në atë kohë nuk e kam kuptuar por e kam kuptuar pasi që e kom anulë konkursin, e kam kuptuar shumë më vonë.

Ndërsa lidhur me draft-vendimin kinse për shkarkimin e z. L.R, është vërtetuar se ky është një draft i cili nuk përmban asnjë emër të askujt e as të L.R, nuk përmban pozitën se cili zyrtar do të shkarkohet, nuk përmban datën e as arsyet se për cilat shkarkohet një zyrtar.

Kjo madje është vërtetuar edhe përmes dëshmisë së dëshmitarit F.T si sekretar i ndërmarrjes TU, përgjegjës për hartimin e shkresave dhe vendimeve në TU, i cili në përgjigjet e tij në faqen 7 në paragrafin 5 të procesverbalit, është përgjigjur: “ Po, me sa më kujtohet është e vërtetë se draft-vendim të cilin e kam përpiluar sipas kërkesës së R.B, nuk ka përmbajtur as emër, as mbiemër të askujt, e as pozitën e personit dhe as arsyet e shkarkimit, ka qenë vetëm një formë dhe një bazë ligjore se si shkarkohen zyrtarët e lartë në përgjithësi, në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. ”

Gjatë dëshmisë së F.Tt, dhënë pranë gjykatës është vërtetuar fakti se, atij nuk i është kujtuar koha dhe mënyra se si i ishte kërkuar përpilimi i draft-vendimit dhe se a ka qenë para apo pas anulimit të konkursit?!

Ai, madje ka vërtetuar faktin se, të gjitha vendimet e Bordit të ndërmarrjes, duhet të kalojnë me shumicë votash dhe se ky draft vendim mund të shërbejë si formë për shkarkimin e secilit zyrtar të lartë .

Gjithashtu është vërtetuar se, asnjëherë nuk është diskutuar në mbledhje të bordit shkarkimi apo mundësia e shkarkimit të L.R dhe asnjëherë nuk ka qenë në rend dite dhe se vendimet në Bord, merren me shumicë votash.

Në dëshminë e dhënë pranë gjykatës F.T, ka vërtetuar deklaratën e dhënë në PTH me datën 04.03.2020 faqe 2 dhe faktin se L.R, nuk kishte një bazë ligjore procedurale për anulimin e konkursit si dhe faktin se, nuk e dinte se nga kush ka pasur presion L.R, kur kishte deklaruar: “ka kërkuar bazën ligjore për anulimin e konkursit dhe se ai i është përgjigjur se nuk ka bazë ligjore për këtë veprim, se me këtë veprim në bazë të Ligjit të Punës dhe Udhëzimit Administrative 07/2017 për Rregullimin e Procedurave në Punësimin Publik, nuk ka një bazë ligjore procedurale për anulimin e konkursit”, “por sa i kujtohet, nuk e ka përmendur se, nga kush po ka presion por vetëm ka dalë nga zyra”.

Andaj, bazuar në fakt e lartcekura mbrojtja kërkon nga kjo Gjykatë, që mos i falë besimin dëshmisë së të dëmtuarit/dëshmitarit L.R, në bazë të faktorëve të disponueshëm: si kredibiliteti i përgjithshëm, konsistenca e dëshmive të tij të dhëna në Policinë e Kosovës, Prokurorinë e Shtetit, veçanërisht objektivitetin dhe cilësinë e dëshmisë/ve së tij dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësorë.

Po ashtu, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor është vërtetuar se në deklaratat e tyre G.B, V.A.H, kanë deklaruar se nuk kanë qenë në dijeni lidhur konkursin dhe se për atë e kanë kuptuar vetëm pasi është anuluar. Të njëjtën e ka deklaruar po ashtu edhe dëshmitarja V.H, në deklaratën e dhënë në Polici me datën 21.01.2020.

Dëshmitari G.B në dëshminë e dhënë pranë Gjykatës me datën 15.05.2023 në faqen 11 para 6 ka deklaruar se: “nuk i kujtohet nëse është audituar dosja e L.B”.

Andaj, mbrojtja kërkon nga Gjykata, që mos t’i falë besimin dëshmisë së dëshmitarit D.M, në bazë të faktorëve të disponueshëm: si kredibiliteti i përgjithshëm, konsistenca e dëshmive të tij të dhëna në Policinë e Kosovës, Prokurorinë e Shtetit, dhe veçanërisht objektivitetin dhe cilësinë e dëshmisë së tij.

Në rastin konkret, dëshmia/deklaratat e dëshmitarit D.M, ishin jo kredibile dhe nuk i plotësojnë këto kritere, duke bërë që të dyshohet për të vlerësuar ngjarjen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

Dëshmitari në fjalë ka treguar se, ai, nuk ka qenë i pranishëm në ngjarjet që ai ka deklaruar dhe nuk ka parë asgjë me sytë e tij. Kjo bën që dëshmia e tij të jetë e bazuar vetëm në informacionin që ka marrë nga të tjerët, siç ka deklaruar edhe vetë ai disa herë gjatë këtij gjykimi. Në këto raste, është e rëndësishme të theksohet se dëshmia e një personi që ka dëgjuar nga të tjerët nuk është e njëjtë me dëshminë e një personi që ka qenë dëshmitar i ngjarjes në mënyrë direkte.

Prandaj, është e rëndësishme të shpreh shqetësimin për vlefshmërinë dhe saktësinë e dëshmisë së dëshmitarit jo kredibilë, duke u bazuar në faktin se ai nuk ka qenë dëshmitar i ngjarjes në mënyrë direkte.

E njëjta vlen edhe për pjesën dërmuese të deklaratave dhe dëshmisë së dëshmitarit F.T, i cili në shumicën e rasteve nuk kishte informacione lidhur me rastin në fjalë. Informacionet që ai ka marrë lidhur me rastin ishin marrë nga të tjerët, pasi që ai nuk ishte dëshmitar i ngjarjes në mënyrë direkte.

Andaj, nga gjykata ka kërkuar që, të analizojë me kujdes të gjitha provat dhe faktorët relevante në rastin aktual dhe të vlerësojë besueshmërinë e dëshmisë së dëshmitarëve në mënyrë të drejtë dhe objektive.

Tutje ke deklaruar se, çështja e punësimit të afërmeve qoftë edhe bashkëshortes duhet kuptuar në frymën e asaj se, e drejta për punë nuk është vetëm një e drejtë bazë me natyrë socialo-ekonomike, por edhe një nga të drejtat themelore të njeriut e garantuar me Kushtetutë, Konventa ndërkombëtare dhe me ligjet tjera, duke mos ia mohuar këtë të drejtë askujt që të konkuroj apo të punësohet dhe duke e lënë në dorë të jo vetëm të Kryeshefit Ekzekutiv por edhe të Komisioneve përkatëse.

Andaj duke pasur parasysh këto theksime, ka kërkuar nga Gjykata, që për të mbrojturin e tij R.B, të bie aktgjykim lirues dhe të pushoj procedurën ndaj tij.

I pandehuri R.B, në fjalën përfundimtare deklaruar se, e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, dhe ka kërkuar nga gjykata që aktakuza të hedhet poshtë pasi gjatë shqyrtimit

gjyqësor është vërtetuar deklarata e tij dhe e mbrojtësit të tij që është i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës, dhe për më tepër e ndjen veten të dëmtuar nga ky proces që nga fillimi sepse ky rast penal ka ndikuar keq në shëndetin e tij, në mirëqenien e tij, e posaçërisht në karrierën e tij, moralisht në familjen dhe në shoqërinë e tij. Është baba i dy fëmijëve të cilët së bashku me atë e presin epilogun e kësaj çështje me shqetësim sepse e gjithë kjo periudhë, sprovë dhe pritje nuk ishte e lehtë as për ata. Që nga viti 2006 e tutje vazhdon në ndërmarrje publike në Kosovë dhe beson fuqimisht që ka kontribuar pozitivisht në çdo dikaster të shtetit ose të ndërmarrjes, dhe deklaroi fuqimisht se gjatë punës së tij në ndërmarrjen Trafiku Urban, pagat janë dyfishuar ose trefishuar, këto janë të dhëna zyrtare. Për fund, vazhdon të beson se drejtësia është i vetmi mjet që i sanksionon padrejtësitë andaj nga gjykata kërkon që të merr aktgjykim lirues.

2. Konstatimet e gjykatës

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 360 të KPPRK-së, gjykata, konstatoi këtë gjendje faktike:

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari R.B, Në cilësinë e personit zyrtar, Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të NPK "Trafiku Urban" në Prishtinë, me dashje merr pjesë personalisht në çështjen zyrtare ku e ka ditur se bëhet fjalë për bashkëshorten e tij L.B, kështu që ka ushtruar autoritetin zyrtar duke i rekomanduar dhe këshilluar në vazhdimësi, nga muaji shtator e deri në muajin dhjetor të vitit 2019, ka kërkuar nga vartësi i tij tani i dëmtuari L.R, i cili kishte pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në ndërmarrjen e lartcekur, përmes komunikimeve verbale dhe elektronike. e veçanërisht përmes sms-ve në "WhatsApp". ashtu që i dëmtuari t'ia punësojë bashkëshorten e të pandehurit L.B në këtë ndërmarrje, ku ishte e angazhuar si praktikante nga ana e Entit për Punësim, fillimisht ka kërkuar që të hapet konkursi për pozitën e Zyrtarit të IT e pas shpalljes së konkursit, ka insistuar dhe drejtuar kanosje që bashkëshortja e tij të punësohet në konkursin e lartcekur, e kur i dëmtuari me datë 23.12.2019, ka marrë vendim për anulimin e konkursit, i pandehuri ka filluar iniciativën për shkarkimin e tij duke e bërë gati draftin e vendimit për shkarkimin e tij si dhe është kanosur se do e rrah të dëmtuarin.

3. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjendjen faktike të lartcekur, trupi gjykues e konstatoi pas administrimit të këtyre provave dëgjimin e:

- të dëmtuarit- dëshmitarit: L.R;
- dëshmitarit: D.M;
- dëshmitarit: F.T;
- dëshmitarit: V.H;
- dëshmitarit: G.B;
- dëshmitarit: V.A.H.

Leximin dhe shikimin e provave materiale si;

- Komunikimet në Whatsapp në mes të të pandehurit R.B me të dëmtuarin L.R, si dhe me dëshmitarin D.M;
- Raporti i ekzaminimit të telefonit të të pandehurit, i datës 25.03.2019, në të cilin raport ceken komunikimet në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit, lidhur me sistemimin në punë dhe kontratën e punës për bashkëshorten e të pandehurit.
- Vendimi për shpalljen e konkursit publik për vendin e punës zyrtar i IT, me nr. 4355, i datës 06.12.2019, i nënshkruar nga Kryeshefi ekzekutiv i TU, L.R, e me të cilin ishin paraparë edhe kushtet që duhet të plotësonte kandidati për këtë pozitë.
- Vendimi i datës 23.12.2019, për anulimin e konkursit publik për vendin e punës zyrtar i IT, me nr. 4355, të datës 06.12.2019, i nënshkruar nga Kryeshefi ekzekutiv i TU, L.R.
- Njoftimi për anulimin e konkursit i datës 23.12.2019; me
- Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës i datës 12.12.2019;
- Drafti i vendimit për shkarkimin e zyrtarit;
- Emaili i datës 30.12.2019;
- disa nga komunikimet në Whatsapp në mes të të dëmtuarit L.R dhe të pandehurit R.B të datës 06.12.2019 dhe 23.12.2019;

- Kërkesa e Trafikut Urban e datës 22.08.2019, drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale- Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, me të cilën shkresë i kanë kërkuar që t'i mundësohet angazhimi i një personi për punë praktike në N.P.K "Trafiku Urban" SH.A, për një periudhë kohore së paku 6 mujore, për nevoja të Teknologjisë Informative në Departamentin e Financave, me orar të rregullt të punës. Si dhe i kanë paraqitur në te kushtet që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozitë.

- Vendimi me nr. 2914, i datës 23.08.2019, i Trafikut Urban, për themelimin e komisionit përzgjedhës, me të cilin është themeluar Komisioni përzgjedhës për angazhimin e një praktikanti në Departamentin e Financave, sipas procedurave të Agjencisë të Punësimit në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në përbërje prej F.T, Kryetar, B.M dhe A.H, anëtarë, i nënshkruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i TU, L.R.

- Lista e distribuimit e datës 22.08.2019, me të cilën Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Agjencia e Punësimit në Republikën e Kosovës, e kishte njoftuar Trafikun Urban, se bazuar në kërkesën e tyre, me nr protokolli 659, të datës 22.08.2019, për plotësimin e një pozite të lirë, në cilësi të praktikantit së paku 6 muaj, punëtor për Teknologji Informative, në Departamentin e Financave, Zyra e Punësimit në Prishtinë, respektivisht zyrtarët për punësim, kanë njoftuar 3 (tre) punëkërkues për intervistë, e cila do të mbahet me datë 26.08.2019 në ora 10: 00 në lokalet e ZP Prishtinë, ku edhe i kanë përcjell emrat e tyre, e në mes e tyre ka qenë edhe L.B.

- Procesverbali i vlerësimit dhe lista definitive e kandidatëve e datës 27.08.2019, i Trafikut Urban- Komisioni intervistues i përbërë nga, F.T, Kryetar, B.M dhe A.H, anëtarë, ku si kandidate e suksesshme nga tre sa ishin gjithsej, kishte dal L.B.

- Vendimi me nr.2969, i datës 28.08.2019, i Trafikut Urban, me të cilin Kryeshefi Ekzekutiv i TU, L.R, kishte aprovuar procesverbalin e listës definitive të kandidatit të suksesshëm, ku kandidat i suksesshëm, ishte përzgjedh L.B.

- Kontrata për punë praktike në kohë të caktuar me nr.3181, e datës 11.09.2019, e lidhur në mes të L.R, në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv në Trafikun Urban, në njërin anë dhe L.B (praktikantja), në anën tjetër, për punë praktike IT, e cila kontratë ishte lidhur për periudhën kokore, duke filluar nga data 09.09.2019 gjerë më datë 08.02.2020, me mundësi vazhdimi.

- Komunikimet në email prej D.M tek L.R, për hapjen e konkursit për zyrtarë të IT të datës 05.12.2019, me të cilin D.M, parashtron nevojën imediate për punësimin e një zyrtari të IT,

në Departamentin e Financave në TU, pasi në vazhdimësi po iu paraqiten probleme me çështje të punëve rreth IT për kompjuter dhe rrjetë interneti.

- Shpallja e konkursit publik në gazetën Epoka e re; ku ishin shpallur kushtet e konkursit për pozitën zyrtar për IT, në Trafikun Urban, ku konkursi ishte i hapur nga data 07.12.2019 deri më datë 23.12.2019.
- Procesverbali i mbledhjes së bordit të drejtorëve i datës 09.12.2019, i mbajtur në Trafikun urban, zyra: Kryeshefi Ekzekutiv, i kryesuar nga R.B- Kryesues, G.B, V.A.H, V.H – anëtarë dhe L.R- KE, të ftuar: D.M- ZKFTH.
- Njoftimi për vazhdimin e kontratës 04.01.2020; dhe
- deklarata e dëshmitares V.H e dhënë në Prokurori me datë 21.01.2020.

3.1. Deklarimi i dëshmitareve

3.1.1 i dëmtuari/dëshmitari L.R, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 31.10.2022, ka deklaruar se, mbetet pranë deklaratës së dhënë ne Prokurori dhe po ashtu ne deklaratat e dhëna në Policinë e Kosovës lidhur me këtë çështje penale. Ka deklaruar se, gjatë vitit 2019-2020, ka punuar ne pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të “ Trafikut Urban”. Fillimisht me R.B, kanë qenë në raporte te mira, i cili në atë kohë ishte në pozitën e kryesuesit te Bordit, ai ishte shefi i tij dhe se bashku kanë bërë punë të madhe për “ Trafikun Urban”. Tutje ka deklaruar se, deri te kjo situatë kishte ardh në momentin kur ishte kërkesa që te punësohej gruaja e tij (R.B) me konkurs te rregullt. Nga një takim që e kanë pasur në “NEST Kafe” afër TU, takim që ka qenë i ftuar nga R.B. Aty e kishte kuptuar se, i gjithë raporti dhe degradimi i raporteve që kanë ardhur mes tyre, ishte në atë kohë nga ndikimi i madh i gruas së tij për punësim. Por fillimisht kishte filluar me disa kërkesa se nuk ishte e sistemuar mirë në zyre, nuk ishte e privilegjuar meqë ishte guraja e kryesuesit te bordit. Meqë gruaja e tij ishte e angazhuar si praktikante, u krijua një atmosferë jo e mirë brenda zyrave te administratës, meqë ajo kishte kërkuar që tavolina e saj te vendosej në pozitë më të mirë ne zyre, që në njëfarë forme e dëmtonte ambientin miqësor brenda zyrës, kështu kishte dëgjuar nga punëtorët e administratës se ndërmarrjes dhe ai si kryeshef. Pas kësaj, i kishte thirrur ne zyre bashke me eprorin e saj D.M dhe ju kishte thënë që të kenë kujdes dhe te sillen mire dhe mos te paraqes kërkesa sepse ambienti i zyrës së TU, kanë qenë të ngushta dmth nuk kanë pasur hapësirë.

Aty në takim e kishte vërejtur se R.B, ka qenë shume i qetë por nuk e kishte atë raportin kolegial që kishin pasur, por gruaja e tij disi në formë kërcënuese, i kishte thënë se “nuk guxon te më këshillosh, meqë unë jam gruaja e kryesuesit të Bordit të TU”. Në atë lokal ka qenë koha e pauzës ora 12;00 deri në 13;00, aty kanë qenë prezent edhe shume punëtorë si zakonisht të TU dhe sjellja e gruas se R.B, e ka bërë të ndihet keq. Ka deklaruar se, Ajo kishte bërë me gisht, me gjestikulacione se, ti nuk guxon të më këshillosh sepse unë jam gruaja e Kryesuesit të Bordit te TU-së

Ai pastaj e kishte kthyer kokën për me pa reagimin e R.B, ndërsa ai (R.B) nuk kishte pasur ndonjë reagim, por ishte perceptim i tij (L.B) se ai e mbështeste gruan e tij. I kishte thënë “ është dashtë të mendosh paraprakisht para se të ma kërcënosh gruan ne zyrën tende”. Ndërsa ky (dëshmitari L.R) i ishte drejtuar me fjalët se, “Unë i jam drejtuar me këshilla pasi që e njëjta nuk ka pasur përvojën paraprake”. Pas kësaj ai i kishte marr gjësendet e tija nga aty dhe ishte larguar.

Ditëve ne vazhdim, ai kishte kërkuar takim me R.B, jo me gruan e tij, për t’u sqaruar me tutje. Takim nuk kishin pasur, por vetëm kishin shkëmbyer sms në platformën Whats App.

Tutja ka deklaruar se, nga R.B, nuk kishte pasur kërcenim ne aspektin fizik, por ishte ndjerë i kërcënuar me humbjen e vendit te punës, pasi që ekziston një nen në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, sipas te cilit Bordi mundet ta shkarkojë kryeshfin në çdo kohë. Në deklaratat që i kishte dhënë më parë kishte thënë se ndihem i kërcënuar, ndaj ky ishte sqarimi sa i përket raporti me R.B. Por ishte ndjerë i kërcënuar nga praktikantja e angazhuar, sepse me atë vrazhdësi që e kishte shikuar, ai e kishte perceptuar si një lloj kërcënimi dhe me të njëjtën i kishte shmang kontaktet, pasi që edhe korridoret ne ndërmarrje ishin shumë të ngushta.

Tutje ka deklaruar se, ata kanë pasur nevojë te punësojnë zyrtar për IT dhe kërkesa ishte imediate, andaj, kanë hapur konkurs te rregullt. Duke parë eskalimin e situatës si kryeshef ekzekutiv, kishte marrë vendim për mbyllje të konkursit meqë mbyllja ishte në kompetencat e tija, ndërsa, përzgjedhja e kandidatëve nuk ishte në kompetencat e tija, por, ishte në duar të komisionit përzgjedhës. Dhe ai, nuk e kishte pritur kohën për formimin e komisionit përzgjedhës kishte marr vendim për mbylljen e konkursit. Si dhe ka deklaruar se, nga R.B, kishte pasur kërkesë për hapjen e konkursit, por nuk ka qenë kërkesa për hapjen e konkursit për gruan e tij, por R.B, ka aluduar në gruan e tij. Ndërsa, ai e kishte hapur konkursin për të punësuar zyrtar të IT-së, pasi që kishin pasur nevojë për ta. Ndërsa ka deklaruar se, nga R.B, kishte pranuar mesazhe kërcënuese si: “ Vij dhe i thyej zyrat, ju kthej prape në shkollë. (duke sqaruar se, me këtë ka dashtë të shtrij autoritetin e tij,) “

Ndërsa, përkitazi me arsyet e ndërprerjes së konkursit, ka deklaruar: “Unë kisha kërkuar nga anëtarët e komisionit, që të më njoftojnë me numrin e kandidatëve që janë paraqitur për atë pozitë

dhe nëse nuk gaboj kanë qenë vetëm dy kandidatë të tjerë dhe gruaja e R.B. Sa i kujtohet kanë qenë vetëm tre kandidatë. Për dy kandidat që ishin që punonin në ndërmarrjen KOST, ku ishte i punësuar R.B dhe atij i kishte shkuar mendja se R.B, nga pozita e Drejtorit të Bordit, kur e merr punën komisioni, mundet me pas ndikim dhe të përzgjidhet pastaj gruaja e tij, dhe ai kishte pasur kompetenca të ndërhyjë te çështjet e komisionit dhe paraprakisht kjo ishte arsyeja që ai e kishte anuluar konkursin”.

Tutje ka deklaruar se, ka qenë iniciativa e vet R.B, që t’i mbështeste komplet stafin në aspektin financiar, meqë lidhej me Ligjin e ardhshme te Pagave. R.B, iu kishte sjellë një matricë të gatshme për ngritjen e pagave dhe me në fund ia kishte përmend që, do të mund të merrte vendim, që të anulonte këto rritje të pagave. Saktësisht nuk i kujtohet t’i ketë thënë se, nëse nuk do të punësohej gruaja e tij do të zbriteshin pagat.

Ndërsa, përkitazi me arsyet e denoncimit të tij ndaj R.B, ka deklaruar se, pas anulimit të konkursit R.B, kishte kërkuar që, shumica e të punësuarve të dërgojnë raporte te punës direkt tek kryesuesi i Bordit dhe këtu e kishte kuptuar një degradim të pozitës së tij dhe të gjitha këto kur mblidhen vijmë te arsye pse ai e kishte denoncuar R.B.

Tutje ka deklaruar se, kompetencat e tij si kryeshef i TU, kanë qenë të përcaktuar me Ligjin për ndërmarrje publike. Ka sqaruar se, menaxhmenti i lartë i ndërmarrjes ku bën pjese edhe krye shefi i përgjigjet Bordit, përzgjidhet nga Bordi dhe kontratat e punës i ndërpritet po ashtu nga Bordi. Të gjitha raportet i dërgohen Bordit. Dhe nga pozita e tij si krye shef ekzekutiv, mund te kërkoj raporte nga vartësit e tij. Pozitën e kryeshefit e ka ushtruar me mandatin e plote d.m.th. tri vite. Ndërsa, ka deklaruar se, me R.B, gjatë punës disa vjeçare, kanë krijuar raporte shoqërore. Ka pohuar faktin se me të akuzuarin R.B, janë takuar edhe pas orarit gjatë mbledhjes se bordit që janë mbajt jashtë orarit të punës. Si dhe ka shtuar se, ka mundësi të jetë takuar edhe kështu, por nuk i kujtohet. Pastaj, duke u ballafaquar nga mbrojtësi i të akuzuarit, me provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka deklaruar se, i kujtohet edhe ahengu ku kanë qenë ai me bashkëshorten e tij, R.B me bashkëshorten e tij dhe një shok i tij me bashkëshorten e tij. Ndërsa, ka qëndruar pranë deklaratës së dhënë në Prokurori, ne faqen 3 paragrafi 1 ku kishte deklaruar: “ se kryesuesi i bordit R.B, vazhdimisht ka kërkuar nga ai që të hapet konkurs për punësimin e bashkëshortes se tij L.B dhe ne vazhdimësi i kishte bërë presion që të hapet si konkurs dhe në një farë mënyre edhe duke e shantazhuar, pasi që ata si menaxhment, kishin kërkuar ngritjen e pagave për të gjithë punëtorët, i njëjti pra R.B, kishte deklaruar se nuk do ta përkrahte këtë ngritje te pagave, nëse nuk i punësohej gruaja e tij me konkurs të rregullt”, ku kishte shtuar se, ka kaluar një kohe dhe mund të mos i kujtohen detajet por e di që nuk i është thënë drejtpërdrejt në sy, por i kujtohet diku si sms i shkruar diku. Si dhe ka shtuar se, NPB i është refuzuar ngritja e pagave dhe kjo

mund të ndodh edhe tek ne, dhe këtë ai e kishte kuptuar atëherë si presion të tërthortë, se zakonisht kur je në pozitën e drejtorit dhe të ulen pagat e stafit, ankesat i adresohen drejtorit dhe pastaj ai duhet të përballet me vartësit e tij.

Ndërsa, në pyetjen e mbrojtësit të të akuzuarit, ju thatë më herët *se* ”nuk do të thotë se ka qenë kërkesa e zotit R.B që të hapet konkursi për gruan e tij”, a është kjo e saktë?

I dëmtuari- dëshmitari L.R, ishte përgjigjur: “Unë thashë që është aluduar dhe për sqarim dua të shtoj se me aludim dua të them se kërkesat e zoti R.B, “Hapeni konkursin, mos pritni më”, pastaj “ pagat mund të zbriten” e të gjitha këto i përmbloodha në shprehjen aludim dhe besoj se këta sms janë në shkresa të lëndës, bile me është thënë mos me prit Vitin e Ri dhe të kryhet çështja”. Dhe këtë aludim e ka nxjerr nga sms. Duke shtuar se, R.B, nuk ka pranua kontakt drejtpërdrejt me të, të cilin ai ia kishte kërkuar vazhdimisht, dhe sikur të ishin takuar, ai do t’ia sqaronte nëse donte me ja pranua gruan në punë apo jo. Ndërsa, përkitazi me arsyet e hapjes së konkursit ka deklaruar se, konkursin nga pozita e kryeshefit ekzekutiv e kishte marrë nga nevoja imediate që e kishin pas në ndërmarrje. Shpesh nuk kishin mundur te komunikojnë me emaila zyrtar dhe ishte dashur te komunikojnë me emaile private. Në publikimet ne webfaqe për transportin publik, mungonte zyrtari përgjegjës me njohuri për këtë çështje, apo çështje të tjera të IT, si instalimi i kompjuterëve, softuerëve brenda administratës. Konkursi është hap për shkak të nevojës. Ndërsa, në pyetjen e mbrojtësit te te akuzuarit se, “ju thatë se zoti R.B ka insistuar që të pranohet gruaja e tij në punë në TU, por në komunikimet mes jush dhe R.B të datës 24.07.2019 ora 09:11 minuta e 55 sekonda, ju i keni shkruar R.B, citoj ” Na po vazhdojmë me punë....puna flet vetë. Flm për mbështetjen, sa te kryej rastin du me marrë L.B, se nuk ka çka me ndodhe, folët dy tri ditë dhe harrohet ajo punë”. A ka qenë ide e juaja me marr në punë L.B? Është përgjigjur, Jo. Ndërsa, ka theksuar se, si kërcenim kur kishin qëndruar ne kafeterinë NEST, në raport me R.B, meqë nuk i kishte ndërhyre bashkëshortes së tij gjatë bisedës së saj, gjesti kulimit me gisht të saj, ai e kishte kthye kokën nga R.B, me pa opinionin e tij, dhe ai nuk kishte ndërhyrë dhe ai e kishte konsideruar një aprovim të tij për reagimin e saj. Nga R.B, nuk e kishte marrë si kërcenim fizik por e kishte marrë si humbje e vendit të punës, por nga zonja L.B, e kishte kuptuar si kërcenim se e kishte bo me u ndie keq, me vrazhdësi të madhe, shikimi i saj ishte i tillë. Ka deklaruar se, pas atij takimi, me R.B, kishin vazhduar komunikimet për çështje të ndërmarrjes dhe nga i cili kishte kërkuar vazhdimisht të takohet për tu sqaruar për atë presion. Në një rast R.B, i kishte thënë “ tu ka nxeh koka dhe kur të ftohesh, takohemi”, kjo i ishte thënë me sms. Ndërsa, përkitazi me pyetjen e mbrojtësit të akuzuarit R.B, në ditën e njëjtë pas takimit në NEST, me datë 13.12.2019 në ora 13:58, ju i keni dërguar një email në adresë zotit R.B, ku i jeni referuar takimit te mëngjesit në NEST, të diskutimeve që keni pasur me zotin R.B dhe L.B dhe ndër të tjera keni deklaruar si në

vijim: “na ndodhi kjo çështje sot, tuj mendu për ma mirë dhe se unë kam folë shlrë dhe pa protokoll në aspektin miqësor, për këtë temë nuk kisha pas qef me ditë D. dhe F., ju e gjykoni vet mirëpo e shoh te arsyeshme që të përmendi se keq kuptimet tona mos ti dijnë ata. Qëllimi im ishte me bisedu që le të ndihet krenare dhe mos të ketë brenga se proceset zhvillohen por nga pakujdesia ime.. është prodhuar efekti i kundërt dhe me vjen shumë keq për L.B se është nervozuar.”. Çka do të thotë ky email për ju? I dëmtuari – dëshmitari është përgjigjur: “Po del që unë ju kam frikësuar autoritetit të tij”.

Ndërsa, për sms që i referohet kërcënues që i kishte marr nga R.B, ka deklaruar se, si e kishte kuptuar atëherë dhe si e kupton tash, gruaja e R.B (L.B), ishte ankuar për hapësira të zyrës dhe i njëjti ka rënë nën ndikim e gruas së tij dhe ka dashur të tregojë autoritet nga pozita e drejtorit të Bordit. Sa i përket fjalës “ju kthej në shkollë” është menduar se ata si administratë kishin vepruar me herët në hapësirat e gjimnazit, por emri i gjimnazit nuk i kujtohet, zyret e reja ku ishin ata, ishin të reja dhe edhe tash njëjtë e kupton d.m.th. të vij t’iu thej zyret dhe t’i kthej atje ku kishim qenë, në gjimnaz. Ndërsa, përkitazi me fjalën “vij jau thej zyret”, ka deklaruar se, nuk kishin diskutuar me bordin e Trafikut Urban, sepse sipas tij, ai sms, ka pas të bëj me shprehjen e arrogancës dhe autoritetit, është i fortë vjen i then zyret, kështu e ka kuptuar atëherë e edhe tani kështu e kupton, si dhe ka shtuar se, kishte paraqitur në Polici, këto kërcënime, mbi bazën e të cilave edhe është duke u zhvilluar kjo procedurë. Ndërsa, e ka vlerësuar si veprim të drejt anulimin e konkursit dhe nuk i kujtohet nëse kishte pranuar ndonjë ankesë lidhur me anulimin e konkursit. Ndërsa, ka deklaruar se ana formale për plotësimin e kushteve të konkursit ishte plotësuar. Ndërsa, përkitazi me sms që i kishte dërguar i akuzuari R.B, me përmbajtjen: “pasdite fillo me punën e L., të kryhet para 31.12”, ka deklaruar se këtë e kishte kuptuar si kërkesë për hapjen e konkursit, kur për shkronjën L. e kishte kuptuar se aludohet për L.B. Dhe gjatë kësaj kohe nuk e kishte kuptuar se është marrë një vendim-draft për shkarkimin e tij, por, e kishte kuptuar pasi që e kishte anuluar konkursin, e kishte kuptuar shumë më vonë. Tutje ka deklaruar se, pas prishjes së raporteve me R.B, nuk i kujtohet sa kishte qenë intervali kohës kur ai kishte marr vendim për shpalljen e konkursit për IT dhe se nuk kishte qenë i detyruar për shpalljen e konkursit. Si dhe ka pohuar se, i akuzuari R.B, nuk i kishte kërkuar drejtpërdrejt gjatë asaj kohe që të punësohet bashkëshortja e tij.

Tutje ka deklaruar se, presioni, kishte filluar gjatë kohës sa ka qenë konkursi hapur, por sa i kujtohet sa kishte qenë konkursi i hapur, R.B, kishte fol për ngritjen e pagave. Me ngritje të pagave është nënkuptuar për të gjithë stafin. Ndërsa, presioni më i madh ka qenë pas anulimit të konkursit, ku në vendimin për anulim të konkursit i kishte cekë arsyet e anulimit të cilin vet e kishte shkruar edhe pse nuk është jurist. Pastaj ka deklaruar se, nuk është i saktë a ka ndodhur

ky presion në kohën e konkursit apo pas anulimit të konkursit. Ka deklaruar se, të gjitha që i ka theksuar në seancë: uljen e pagave, shpalljen e konkursit, thyerjen e zyrave i kishte konsideruar si presion. Ndërsa, ka pohuar faktin se nuk ka qenë kompetencë e të akuzuarit R.B, që edhe ai të kërkojë që të shpallet konkurs për nevoja të ndërmarrjes, sepse, kjo ishte kompetencë e KE. Mundet vetëm për të dhënë si këshillë apo rekomandim se vetëm si vendim i bordit me shumicë të votave, por s'ka pasur të drejtë. Ka theksuar se, Bordi ka kompetence të punësojë vetëm menaxhmentin e lartë por jo edhe stafin. Tutje sipas tij, tre anëtarët e Bordit, i ishin frikësuar autoritetit të Kryesuesit të Bordit, për shkak të raportit që ai (R.B) i ka pas me Komunën e Prishtinës. Ka deklaruar se, ai kishte qenë në marrëdhënie pune deri në vitin 2021, kur kishte ardh Bordi i Ri, i cili nuk ia kishte vazhduar mandatin. Ndërsa, konkursi ishte rishpallë menjëherë pas një kohe dhe nuk kishin pritur shumë gjatë dhe ishte punësuar aty një profesionist i IT-së. Tutje i dëmtuari – dëshmitari ka deklaruar se, nevoja për zyrtar të IT, ka qenë më herët, dhe së bashku me bordin e kishin vendosur në strukturën organizative pozitive për zyrtar të IT. Nuk i kujtohet nëse TU, ka pasur planifikim për punësimin e një zyrtari të IT për vitin 2019, ndërsa për vitin 2020, ishte i sigurtë që po, sepse vet e kishte fut në buxhet. Nevoja për zyrtar të IT, mendon se ka qenë kërkesë e brendshme e administratës. Ndërsa, ka deklaruar se, rritja e pagave duhej të ndodhte sipas ligjit për pagat, dhe ata e kishin krijuar një matricë sipas të cilës do të kishin rritje pagash. Nuk i kujtohet nëse ka pasur ankesa për procedurën e rekrutimit, sepse me këtë merret komisioni i ankesave. Ai nga Komisioni për rekrutim kishte kërkuar numrin e kandidatëve dhe kandidatët, ku komisioni pas hulumtimit e kishte informuar se kush janë kandidatët dhe se kushti ligjor për tre kandidatë përmbushet, por dy kandidatet e tjerë kanë qenë punëtorë të kompanisë KOST, ku atje pagat janë shumë të larta dhe s'ka logjike që ata të vijnë në TU, për një pagë më të ulët si dhe ka qenë edhe L.B, por logjika e tij e kishte quar në atë R.B, ka punuar në atë kohë në KOST dhe kishte menduar, ka qenë vetëm ide e tij, se ai iu kishte kërkuar atyre vetëm të aplikojnë sa për të përmbushur kushtin ligjor. Po ashtu ka deklaruar se, L.B, ka pasur te kryer IT dhe për këtë arsye ajo edhe është angazhuar, nga Inspektorati i Punës. I kujtohet se, i kishte shkruar një vendim dhe ata e kishin bërë ankesën e tyre ndaj atij vendimi dhe mendon që ka përfunduar ajo çështje, sepse i punësuar i me kontratë praktikant nuk konsiderohet si i punësuar i rregullt. Në mënyrë eksplicite në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se, “R.B nuk më ka thënë decidivisht “ Merrma gruan ne punë”. Ndërsa, ka theksuar se, kërkesat e tij kanë qenë në mënyrë indirekte për t'ia punësuar gruan dhe mendon se në sms është thënë se janë punësuar plotë të tjerë e të punësohet edhe kjo. Disa herë ishte anku në raportet shoqërore që i kishin pas. Përsëri ka potencuar faktin se, shkarkimin e kryeshefit ekzekutiv e bënë krejt Bordi, por në strukturën e atëhershme Kryesuesi i Bordit ka qenë shumë autoritativë.

Tutje ka deklaruar se, punësimi bëhet mbi bazën e meritave dhe ato merita vlerësohen nga komisioni vlerësues. Nga komisioni vetëm kishte kërkuar të dhëna për numrin dhe emrat e kandidatëve, por nuk ishte lëshuar në dosjet e tyre nëse ata janë kandidatë që plotësojnë kushtet ligjore për tu punësuar sipas konkursit. Si dhe ai si KE, nuk kishte pas qasje në dosjet e aplikantëve, por në emrat që kam mësuar nga komisioni e kishte kuptuar se, nuk ka brumë për t'u zhvilluar një procedurë e mirëfilltë. Beson që L.B, i ka plotësuar kushtet ligjore për atë pozitë, por ajo gjatë kohës sa ishte e angazhuar si praktikante, nuk ishte treguar se ishte e aftë të kryejë profesionalisht atë punë dhe në atë kohë e kishin angazhuar një zyrtar tjetër të IT, për t'iu mbuluar këto shërbime me kontratë për shërbime të veçanta. L.B ka qenë praktikante e angazhuar me pagesë, në TU.

3.1.2 Dëshmitari, D.M, në dëshminë e tij, të paraqitur në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.02.2023, ka deklaruar: mbetet pranë deklaratave të tij të dhëna në Polici dhe Prokurori. Ndërsa ka deklaruar se, nuk ka qenë në rrjedha si ishte ardhur deri tek marrja e L.B si praktikante në Trafikun Urban, pasi ai nuk kishte qenë përgjegjës për këtë, por ka qenë L.R, e cila kishte shkuar aty si çdo praktikant tjetër, dhe ajo kishte qenë praktikante për çështje të IT-së për Zyren e Financave. Përderisa ai personalisht kishte qenë përgjegjës për financa në Trafikun Urban. Ku pas ballafaqimit të tij nga ana e Prokurorit të Shtetit, me deklaratën e tij të dhënë në Prokurori me datë 21.02.2020, ku kishte deklaruar se “sa i përket punësimit të L.B, e njëjta sikurse shumë praktikantë që kanë ardhur në Ndërmarrjen Publike Komunale, e njëjta ka ardhur sipas Agjencisë për Punësim” ka pohuar se kështu ja qenë, por që ka kaluar një kohë e gjatë dhe ato që i kishte deklaruar atëherë kanë qenë më të freskëta. Ka deklaruar se, L.B, në fillim kur ka ardhë ka qenë shumë e mirëpritur, komunikimin e kanë pasur shumë të mirë, pas një kohe aty është shfaqur një mos-harmoni në zyren ku ka qenë e sistemuar L.B, pasi kushtet në zyre kanë qenë jo të mira dhe tavolina e L.B, ka qenë tek dera edhe i ka ra pak ftohtë edhe ka kqyr me ndërru vendin edhe aty mes kolegëve ka fillu kërkesa për më ndërru zyren. Sipas perceptimit të tij, L.B, ka tentuar me qenë më e privilegjuar pasi bashkëshortin e ka pasur drejtor të Trafikut Urban, e deri tek ky konstatim kishte ardhë duke u bazuar në sjelljet e saj, si lëvizjet pak më ozgon(është ndjerë më komod), por nuk ka dëshmi të tjera. Ajo ka kërkuar m'u ulë në një karrikë tjetër sepse i ka ardhur të ftohtë aty ku ka qenë, dhe punëtorja që është dashtë me dalë në vendin ku ka qenë L.B ka qenë një punëtoare e vjetër - me përvojë gati 30 vjeçare, dhe ai nuk kishte lejuar veprime të tilla, sepse e kishte konsideruar të padrejtë. Tutje ka deklaruar se, kërkesa e L.B për me ndërru vendin ka ardhur nga Kryeshefi L.R, i cili ka kërkuar nga ai (dëshmitari D.M) që t'ia ndërroj vendin L.B, ai i kishte thënë, jo nuk bën se ajo që duhet me dalë është e moshuar dhe ai i trajton njerëzit në

mënyrë të barabartë. Lidhur me konkursin ka deklaruar se, nuk i kujtohet tani kur është hapur konkursi por, e di që është hapur konkursi por, se çka është biseduar para hapjes së konkursit ai nuk e di, nuk i kujtohet tani, por ato që i kishte deklaruar më herët janë më të freskëta. Ka qëndruar pranë deklaramit të tij, të dhënë në Prokurori me datë 21.02.2020, në faqen e tretë, pasuesi i dytë ku ka deklaruar “me sa unë kam parë, i pandehuri R.B, në vazhdimësi ka ushtruar presion tek Kryeshefi Ekzekutiv L.R, që të hapet konkurs për punësimin e bashkëshortes së tij L.B si IT, kjo ngase sa e kam kuptuar unë, L.B, nuk ndihej mirë në pozicionin e saj si praktikante dhe i kërkonte që të shpallej konkurs, dhe e di se L.R më ka thënë se jam në presion nga R.B, ngase i njëjti po më kërkon hapjen e konkursit dhe punësimin e bashkëshortes së tij, dhe i njëjti në vazhdimësi i bënte presion L.R që të hapej konkursi”. Ka pohuar faktin se raportet në mes të, R.B, në cilësinë e Drejtorit të Bordit të Trafikut Urban dhe L.R, në cilësinë e Kryeshefit të Trafikut Urban, kanë pasur shumë harmoni në mes vete, dhe kur filloi çështja lidhur me kërkesat e L.B, për punësim, erdhi puna deri te lajmërimi tek organet për këtë rast. Po ashtu ka pohuar faktin se, ai me datë 05.01.2020, e kishte shkru një deklaratë me kompjuter, pasi që këtë ia kishte kërku L.R, pasi që i kishte thënë, se kështu është më mirë se e kishte paraqit rastin në Polici dhe i kishte dhanë edhe emrat e tyre. Tutje ka deklaruar se, L.R, qysh i kishte thënë atij, R.B, i ka bërë presion për me hapë konkursin, por ai (dëshmitari) nuk kishte qenë prezent për me dëgju komunikimin e tyre. Po ashtu ka pohuar faktin se, është e vërtetë ajo që kishte deklaruar në Prokurori me datë 21.02.2020, në faqen e tretë, pasuesi i dytë, rreshti i 10-të, ku kishte deklaruar se “R.B, sipas L.R, po kërkonte që të hapej konkursi dhe punësimin e bashkëshortes së tij, dhe i njëjti i bënte presion L.R që të hapej konkursi, nuk e di si kanë rrjedhur bisedat, por një ditë, konkretisht me datë 06.12.2019, L.R, si Kryeshef Ekzekutiv, kishte shkuar dhe kishte biseduar me atë dhe F.T dhe i kishte thënë se, duhet që të hapim konkurs për pozitën e IT-së, për shkak se jam në presion të madh nga tani i pandehuri R.B, si kryesues i Bordit dhe i njëjti nuk po më lë rehat pa u hapë ky konkurs”. Ndërsa, nuk i kujtohet se çka kanë biseduar me L.R dhe L.B, në takimin që kishin pasur takim me datë 13.12.2019 edhe atë pasi që kjo iu rikujtua nga Prokurori, pasi ia lexoi atë deklaratë, lidhur me këtë bisedë, por nuk i kujtohet edhe ajo që i kishin thënë ai edhe L.R, L.B, që ta kemi hapë konkursin dhe se çdo kërkesë që ke të shkojë përmes nesh e jo përmes bashkëshortit të saj-R.B. Tutje ka deklaruar se, ai nuk kishte qenë prezent në kafiteri kur R.B me L.B, kanë qenë në drekë. Por, që ai një ditë tjetër kishte shkuar tek restorant “Saranda”, e cila gjendet afër banesës së R.B, me qëllim që t’i qetësoj raportet apo mosmarrëveshjet në mes të R.B dhe L.R. Si dhe ka shtuar se, është e vërtetë që R.B në bisedë e sipër i kishte thënë “vij e rrehi L.R, i thej xhamat” por këtë e kishte thënë për shkak të mllëfit që e ka pasur aty për aty, dhe pikërisht për shkak të kësaj shtuate të tensionuar ai kishte shkuar për të biseduar me R.B. Ai

gjithashtu ka deklaruar se, ishte marrë me qetësim të raporteve në mes të L.R dhe R.B dhe jo me çështje të konkursit, por është e vërtetë që ka pasur të bëjë me çështjen e konkursit. Ka vazhduar me deklarimin se, i kujtohet që me datë 23.12.2019 L.R, i kishte thënë që ka marrë vendim me anulë konkursin, e kishte pasur një justifikim se kanë aplikuar edhe disa të tjerë, e për të cilët i kishte treguar sigurisht L.R, sepse ai nuk kishte pasur informata për ata kandidatë. I kujtohet që R.B, i kishte shkruar sms dhe i kishte thënë “e paska anulë konkursin e L.B” dhe ka aludu në L.R. Si dhe ka shtuar se, pas anulimit të konkursit R.B, kishte kërkuar që L.B, t’i vazhdohet praktika sikurse që i është vazhduar edhe rasteve të tjera, që ka mund me iu vazhdu. Po ashtu ka deklaruar se, kishte dëgjuar në komunikim nga të tjerët, nuk mundet me ditë kush kanë qenë ata, që R.B, ka kërkuar nga F.T, që të përgatitet një vendim për shkarkimin e L.R. Si dhe ka shtuar se, është e vërtetë që kishte pasur komunikime përmes Whats app-it me R.B, dhe ato i kishte deponuar në Policinë e Kosovës. Ndërsa, në pyetjen e Prokurorit se, në deklaratat të cilat i keni dhënë në Prokurori dhe në Polici keni deklaruar se, L.R, ka kërkuar nga ju që ta hapni ju konkursin për zyrtar të IT-së, për shkak të presionit që ka nga z. R.B, çka nënkuptoni me presion? Dëshmitari ishte përgjigjur: “presionin e kuptoj mbi bazën e insistimit, unë nuk e kuptoj dozën e insistimit qysh e ka kuptu ai vet, dhe unë nuk mund të hapi konkurs për IT pasi unë jam tek financat”. Dhe pas kërkesës së L.R, ai nuk kishte hapur këtë konkurs. Po ashtu ka deklaruar se, kishin bërë vlerësim të nevojave të Departamentit të Financave për zyrtar të IT, dhe kanë pasur nevojë dikush me iu ndihmuar në Zyren e Financave. Tutje ka deklaruar se, është e vërtetë që kanë pasur nevojë për zyrtar të IT-së tek Financat pasi nuk kanë pasur të tillë. Pas ballafaqimit të dëshmitarit, nga ana e mbrojtësit të të akuzuarit R.B, lidhur me komunikimet përmes emailit me kërkesat e dëshmitarit drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv L.R, përmes emailit zyrtar, me datë 05.12.2019, në ora 15:28, dhe emailin e dytë të së njëjtës datë, në ora 14:50, përmes të cilave kishte kërkuar hapjen e konkursit për zyrtar të IT-së në Departamentin e Financave, dhe e kishte elaboruar nevojën për një zyrtar të IT-së, i njëjti ka pohuar, po, është e vërtetë sepse kanë pasur nevojë për një zyrtar të IT-së. Si dhe nevojën për një zyrtar të IT-së, ai vet e kishte elaboruar në mbledhjen e Bordit të Trafikut Urban. Gjithashtu ka deklaruar se, pas mbledhjes së Bordit është hapur konkursi sipas kërkesës së tij, për IT. Por, ai nuk ka qenë anëtar i Komisionit për përzgjedhjen e punëtorit të IT, e as nuk e kishte njohur ndonjërin nga kandidatët që kanë aplikuar për pozitën e IT. Si dhe pohon faktin se, pas anulimit të konkursit, derisa të zyrtarizohet kjo, ai nuk i kishte treguar R.B, që mos të bëhej ndonjë mosmarrëveshje.

Ndërsa, në pyetjen e mbrojtësit të të akuzuarit R.B, se komunikimin e datës 24.12.2019, përmes Whatsapp të cilin e keni dorëzuar në Polici ku ndër tjera R.B ka thënë se “ia thirri Shqipen e ia kërcënoj e tani e sheh qysh është”, ndërsa ju jeni përgjigjur “ky e merr shumë me tension dhe

mandej reagon pa ndalë, qata pak maturi”, a nënkupton kjo se L.R i merr gjërat me tension dhe reagon pa maturi? Dëshmitari ishte përgjigje: Ashtu është duk ato ditë. Tutje ka deklaruar se, konkursi për aq sa di ai, ashtu siç i kishte thënë L.R, është anuluar për shkak se L.R, e kishte kuptuar si inskenim nga aplikantë të tjerë, që po krijohet mundësia për me ardhë deri te punësimi i L.B. Andaj, për mos me ardhë aty L.R, i kishte thënë që po e anuloi konkursin e shpallur. Tutje ka deklaruar se, nuk i kujtohet tani çka i ka thënë në komunikim përmes Whatsappit R.B, por deponimet janë në shkresat e lëndës. Po ashtu ka deklaruar se, nuk ka pasur kërkesë urdhëruese nga R.B për shpalljen e konkursit.

3.1.3 Dëshmitari F.T, në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.05.2023, ka deklaruar: Ka kaluar një kohë goxha e gjatë nëse mund ta kujton, por e din që L.B, fillimisht kishte shkuar si praktikante në Trafikun Urban dhe pastaj e din që është hapur një konkurs për IT dhe është mbyllur ai konkurs. Tutje ka deklaruar se, R.B, atij nuk i ka thënë asgjë lidhur me këtë konkurs, pasi që nuk ka qenë kompetencë e tij, as të hap e as të mbyll konkurs. Tutje ka deklaruar se, R.B, i kishte kërkuar përpilimin e një mostre të vendimit për shkarkim të në atë kohë kryeshefit ekzekutiv L.R, por që arsyt nuk ia kishte thënë dhe se nuk i kujtohet data e as koha kur kishte ndodhur kjo, e as mënyra e kërkesës, përmes telefonit apo ndryshe. Ka deklaruar gjithashtu se, zakonisht draft-shkresat e Bordit të ndërmarrjes i përpilon sekretari i ndërmarrjes, e të cilat Bordi edhe mund t’i ndryshojë, e që në atë kohë, ai ka qenë sekretar i ndërmarrjes. Sa ka qenë ai në ndërmarrje, ai vendim asnjëherë nuk ka dalë në Bordin e ndërmarrjes, nuk është në dijeni se çfarë ka ndodhur me atë vendim. Ndërsa, për anulimin e konkursit nga L.R, ka deklaruar , arsye konkrete pse është anuluar konkursi nuk di, por që në zyre kur kishin qenë ai dhe D.M kishte shkuar kryeshefi ekzekutiv dhe kishte thënë që do ta anuloi konkursin. Nëse nuk gaboj, D. e ka pyetur se përse, dhe i ka thënë se, po kam presion edhe me sa më kujtohet ka dalë nga zyra ku kanë qenë. Por, nuk e dinte se prej kujt ka pasur presion. Tutje ka deklaruar se, se është e vërtetë që në atë kohë ka pasur nevojë për një zyrtar të IT-së pasi që nuk ka pasur zyrtar të tillë në ndërmarrje. Si dhe ka shtuar se, nuk i kujtohet në detaje nëse sipas kërkesës së Kryeshefit e ka përgatitur konkursin për IT, apo atë e kanë përgatitur Burimet njerëzore. Dhe sa e mban në mend, ai e ka përpiluar vendimin për hapjen e konkursit. Ka theksuar se, qëndron pranë këtij deklaramit të mëhershëm lidhur me bazën ligjore të anulimit të konkursit, nga ana e KE, dhe për aq sa i kujtohet tani kryeshefi L.R, kishte thënë do ta anuloi konkursin, ndërsa, ai i ka thënë që nuk ka bazë ligjore për anulim për shkak se Udhëzimi Administrativ 07/2017, i parasheh në mënyrë decisive kriteret për anulimin e një konkursi dhe pas kësaj atëherë kryeshefi kur e ka pyetur D.,

se pse po don me anulë, kryeshefi ka thënë se po kam presion, por sa më kujtohet nuk e ka përmendur se nga kush po ka presion por vetëm ka dalë nga zyra e tyre.

Ndërsa, ka deklaruar se, me sa i kujtohet është e vërtetë se draft-vendimi të cilin e ka përpiluar sipas kërkesës së R.B, nuk ka përmbajtur as emër, as mbiemër të askujt e as pozitën e personit dhe as arsyet e shkarkimit, ka qenë vetëm një formë dhe një bazë ligjore se si shkarkohen zyrtarët e lartë në përgjithësi në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Draft-vendimi i përpiluar nga ai mund të shërbejë si formë për shkarkimin e secilit zyrtar të lartë, përveç që duhet me i përshtat arsyet dhe të gjendet baza ligjore. Nëse nuk gabon, në atë draft-vendim kanë qenë të gjitha bazat ligjore për shkarkimin e zyrtarëve ligjorë dhe varësisht nga arsyeja mund të merret baza ligjore përkatëse. Nuk i kujtohet koha kur është kërkuar nga ai përpilimi i një draft-vendimi, a ka qenë para apo pas anulimit të konkursit, por nuk e di se a ka pasur drafti datë. Si dhe ka shtuar se, të gjitha vendimet e Bordit të ndërmarrjes duhet të kalojnë me shumicë votash, kështu e parasheh ligji.

3.1.4 Dëshmitari G.B, në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.05.2023, ka deklaruar se, po, R.B, e njeh prej vitit 2017, kur ishte përzgjedhur anëtar i Bordit. Gjatë vitit 2019 në Trafikun Urban, ka qenë anëtar i Bordit dhe kryesues i Komisionit të Auditimit. Ndërsa, ka deklaruar se, nuk ka qenë i njoftuar lidhur me konkursin e shpallur për IT dhe për te kishin kuptuar më vonë, pasi ishte hapur, pasi që ata (Bordi) nuk kishte pasur kompetencë që ta aprovojë të njëjtin. Poashtu, për anulimin e tij, kishin kuptuar pasi ishte anuluar. L.R veç iu kishte thënë se po e anulon konkursin, por kjo nuk ka qenë kompetencë e tyre. Arsyet e anulimit sipas L.R kanë qenë se R.B, po i bën presion, por ai nuk e kishte parë e as vërejtur nëse R.B, i ka bërë apo jo presion. Si dhe ka shtuar se, është e drejtë e çdo qytetari të Republikës së Kosovës, që të aplikojë në të gjitha ndërmarrjet apo institucionet shtetërore pa diskriminim dhe si qytetar i lirë i Kosovës. Pranimi i praktikantëve nuk është përgjegjësi e Bordit të ndërmarrjes, Bordi e përzgjedh vetëm menaxhmentin e lartë dhe askënd tjetër, ndërsa praktikantët zgjedhen nga menaxhmenti përkatës i ndërmarrjes. Po ashtu ka deklaruar se, R.B, atij, asnjëherë nuk ia ka përmendur se dëshiron me punësu gruan në ndërmarrje. Si dhe ai nuk kishte dëgjuar, që R.B, i ka bërë presion dikujt që gruaja e tij L.B, të punësohet në ndërmarrje. Po ashtu ka deklaruar se, për aq sa i kujtohet, asnjëherë në mbledhje të Bordit nuk është diskutuar për shkarkimin e kryeshefit ekzekutiv L.R. Mbledhjet e Bordit i kishte kryesuar Kryesuesi R.B, ndërsa në mungesë të tij i ka kryesuar ai (dëshmitari). Gjithashtu ka deklaruar se, Kryeshefi L.R, pas anulimit të konkursit përmes telefonit i kishte thënë se, ka presion prej R.B, por ai e di që raportet mes tyre kanë qenë tepër të mira, por nuk i kishte treguar për çfarë lloj presioni po flet. Ai nuk i di arsyet pse R.B dhe Kryeshefi ekzekutiv L.R, i kanë

prishur raportet, të cilat i kanë pasur shumë të mira, dhe ai mund të dyshoj që ka qenë për shkak të konkursit, por ky është vetëm spekulim. Tutje ka deklaruar se, L.B nuk ka qenë e punësuar, është pranuar vetëm si praktikante në ndërmarrjen e Trafikut Urban dhe zyrtarisht nuk kanë konstatuar se kjo përbën ndonjë shkelje etike. Tuje ka sqaruar se, praktikantët janë pranuar përmes Entit të Punësimit dhe ata nuk kanë pasur çasje në atë pjesë, pranimin e praktikantëve e ka bërë menaxhmenti bashkë me Entin e punësimit. Bordi është marrë me politika të larta e jo me punësimin e praktikantëve dhe nuk i kujtohet nëse e kanë audituar dosjen apo procedurën e rekrutimit të L.B. Tutje ka deklaruar se, i kujtohet që ndërmarrja ka pasur nevojë për një zyrtar të IT-së, pasi që nuk ka pasur asnjë të tillë në ndërmarrje. Ndërsa, planin e menaxhimit të personelit e bën menaxhmenti me stafin që e kanë, ndërsa e aprovon Bordi dhe Bordi e aprovon vetëm pozitën por jo edhe punësimin e personit konkret. Pasi është bërë riorganizimi i ndërmarrjes, është bërë organogrami i ri dhe është aprovuar organogrami. Për atë që i kujtohet, në Bord, ishte aprovuar pozita e zyrtarit të IT-së së ndërmarrjes, por e njëjta është aprovuar si paketë edhe me pozitë të tjera.

3.1.4 Dëshmitarja V.A.H, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 15.05.2023, ka deklaruar, R.B, për herë të parë e kishte takuar kur e kishin pasur mbledhjen e parë të Bordit në Trafikun Urban dhe është e vërtetë që ajo gjatë vitit 2019, ka qenë anëtare e Bordit në Trafikun Urban. Si dhe ka shtuar se, nuk ka dijeni lidhur me konkursin për IT në ndërmarrjen e Trafikut Urban. Ajo kishte dëgjuar fjalë që bashkëshortja e R.B, ishte praktikante në Trafikun Urban, por zyrtarisht nuk ka pasur asnjë informacion. Ka pohuar faktin se, është e vërtetë që ka dhënë deklaratë në Polici dhe ka deklaruar se ka qenë pjesë e Komisionit të Auditimit i përbërë prej 3 anëtarëve të Bordit. Gjatë auditimit nuk i kujtohet që kanë vërejtur ndonjë parregullsi në punësimin e praktikantëve. Në Trafikun Urban, kanë qenë në kohën e mbajtjes së mbledhjeve dhe në ato mbledhje ajo, nuk kishte vërejtur ndonjë raport të mirë apo të keq, por kanë qenë raporte normale mes kryesuesit dhe kryeshefit të ndërmarrjes. Tutje ka ritheksuar se, Bordi i ndërmarrjes ka rekrutuar vetëm zyrtarët e lartë, ndërsa nuk ka pasur kompetencë për staf dhe menaxhment të ulët. Në mbledhje të Bordit nuk i kujtohet që është diskutuar shkarkimi i kryeshefit të ndërmarrjes. Gjithashtu ka deklaruar se, ai nuk është në dijeni që kryesuesi i Bordit R.B, të ketë ushtruar presion ndaj dikujt për punësimin e bashkëshortes së tij në ndërmarrjen publike Trafiku Urban.

Dëshmitarja L.B, pas njoftimit nga Gjykata, për të drejtat e saja, nga neni 124 të KPP, për të u mos u deklaruar.

Meqenëse për shkaqe shëndetësore nuk ka mundur të prezantojë dëshmitarja e propozuar nga Prokuroria V.H, Prokuroi i Shtetit ka propozuar që deklarata e saj të lexohet, e me këtë propozim janë pajtuar edhe, i dëmtuari L.R, si dhe i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

Kjo dëshmitare në deklaratën e saj të dhënë në Polici, me datë 21.01.2020, kishte deklaruar se, ka qenë anëtare e Bordit të trafikut Urban, në kohën kur edhe R.B, ka qenë kryesues i Bordit dhe L.R, Kryeshef ekzekutiv. Ka deklaruar se, nuk kishte njohuri lidhur me konkursin për zyrtar të IT. Ndërsa, për mbylljen e tij ishte njoftuar nga anëtari tjetër i Bordit G.B, i cili e kishte njoftuar rreth rastit si kishte ndodhur dhe pse ishte anuluar konkursi. Dhe vlerësuar sipas deklaramit të kolegut të tij, e ka vlerësuar si të drejt anulimin e konkursit. Ka deklaruar se, raportet në mes të R.B dhe L.R, kanë qenë të mira dhe se nuk ka dijeni për mosmarrëveshjet në mes tyre.

3.3 Provat materiale

3.3.1 Komunikimet në Whatsapp në mes të të pandehurit R.B me të dëmtuarin L.R, si dhe me dëshmitarin D.M; nga të cilat komunikime, Prokuroria ka shkoqitur ato si në vijim:

“ Npb ju refuzua propozimi i pagave, pasi që kanë filluar kështu, unë nuk kam vullnet me mbrojt propozimin tuaj që u dal në bord para aksionareve, le te kthehet e nera me të mirë', ndërsa L.R iu përgjigjet "R.B me shkru mos po keqkuptohemi. Ma mirë, shihemi e tjerat kur të dush" pastaj në sms-in tjetër " masdite fillo punën e L.B Të kryhet para 31. 12", sms tjetër "vëllaçko, Mos e prit janarin. Nisne konkursin. Mundësisht' pastaj në smsin që iu ka drejtuar L.R " a po mendon qe ke vepru drejtë", L.R të është përgjigjur se 'kjo pyetje është për ty se a ke mendu hiq kur ke filluar presionin ndaj meje duke më krijuar stres së bashku me gruan tënde", më pas i pandehuri ka vazhduar "je tu punu me insinuata qëju i keni nis mos ke fillu me gruan tënde diçka, ok shihemi, prite rradhën teme", L.R të është përgjigjur dhe nuk dole asnjëherë të takohemi dhe të sqarohemi se cka është i gjithë ai presion, jo i thej zyret, jo Vij i Uli zyrtarët vet nëpër zyre etj etj, pra kompetencat ekzekutive i ka KE për menaxhim të ndërmarrjes dhejo kryesuesi", R.B ia kthen "popo e shohim po e pash qysh ike trajtu puntorët e tij". pastaj sa i përketë sms-it që i pandehuri ia ka drejtuar D. lidhur me L.R: "ia thirri Shqipen ia kërcënoj", sms tjetër "PO pres deri me 15janar. Jo që po e caktoj afatin. Por nuk ja vlen une me rujt ata kur ai me sulmoi me anulim konkursi” në sms-ët që i pandehuri ja ka drejtuar D. lidhur me L.R, të dt. 24.12.2019 "me ke kërcënua mu me gjykata e sene, bre nanën e pisit, se rrehen pak e ka, le të rrin shlirë se i Vij gjatë ditës", D. të është përgjigjur "jo bre nuk bon ashtu", i pandehuri sërish ia ktheni "për qata ik si mace prej aty". D. i përgjigjet "se bohemi lajm i keq". i pandehuri sërish i thoni se "e pres

masnesër aty, po tja kaj nanën me lajme e me krejt, ai u ngut, pa e diskutu me mu e anuloi, e kam kompetencë po thot, provokim direkt, atëherë pse e nise, të kqyrim a guxon me ja nal praktikën L.B, qatëherë skam durim aspak, a ika koqet te shpija a i ka me veti", si dhe sms të tjerë.

Raporti i ekzaminimit të telefonit të të pandehurit, të datës 25.03.2019, në të cilin raport ceken komunikimet në mes të të pandehurit dhe të dëmtuarit, lidhur me sistemim në punë dhe kontratën e punës për bashkëshorten e të pandehurit.

Vendimi për shpalljen e konkursit publik për vendin e punës zyrtar i IT, me nr. 4354, i datës 06.12.2019; me të cilin është shpallur konkursi publik për IT, e në të cilin definohej kushtet e kandidatëve. kualifikimi, paga dhe kohëzgjatja e kontratës.

Vendimi i datës 23.12.2019, për anulimin e konkursit publik për vendin e punës zyrtar i IT, me nr. 4355, të datës 06.12.2019, ku edhe janë dhënë arsyet për anulimin e konkursit.

Njoftimi për anulimin e konkursit i datës 23.12.2019; me të cilin janë njoftuar kandidatët për anulimin e konkursit nr. 4355. i cit. 06.12.2019.

Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës i datës 12.12.2019; me të cilin vendim është themeluar Komisioni përzgjedhës i aplikacioneve për procedurat e rekrutimit për pozitën Zyrtar i IT, në përbërje prej: V.K, Sh.M dhe M.I.

Drafti i vendimit për shkarkimin e zyrtarit, i cili nuk përmban emër, mbiemër, datë pozitive apo diçka që e identifikon se kujt i dedikohet ky vendim, por thjeshtë është një draft formular për shkarkim të një zyrtari publik.

Emaili i datës 30.12.2019; me të cilin email, i akuzuari R.B, ka kërkuar nga L.R, që të dërgohen raportet javore si gjithmonë të pozitave të punës, si deri tani.

Komunikimet në Whatsapp në mes të të dëmtuarit L.R dhe të pandehurit R.B të datës 06.12.2019 dhe 23.12.2019, ku diskutohet për çështje të ri sistemit të punëtorëve nëpër zyra të TU, çështje të pagave, si dhe vërehet një komunikim i tensionuar në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit, ku i dëmtuari i fillimisht i kishte sugjeruar që të flasin me zë, pasi kështu mund të keqkuptohen, por i akuzuari kishte refuzuar, më pas i dëmtuari e kishte kanosur me paraqitje në institucione

përgjegjëse, për ta mbrojtur dinjitetin dhe integritetin e pozitës së tij, si KE në Trafik Urban, ndërsa, i akuzuari ia kishte kthyer se nuk janë kërcënime, dhe siç shihet nga kjo provë i dëmtuari i referohet pozitës së tij zyrtare, por që nga ky komunikim nuk vërehet asnjë lloj kërcënimi i të akuzuarit ndaj tij.

Komunikimin në WhatsApp në mes të akuzuarit R.B dhe dëshmitarit D.M, diskutohet lidhur me raportet e tensionuara në mes të dëmtuarit L.R dhe D.M,

Kërkesa e Trafikut Urban e datës 22.08.2019; për angazhimin e një praktikanti për punë të IT; Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës me nr. 2914, i datës 23.08.2019; për angazhimin e një praktikanti për punë të IT në NPK Trafiku Urban në Prishtinë, Lista e distribuimit e datës 22.08.2019; nga enti i punësimit; Procesverbali i vlerësimit dhe lista definitive e kandidatëve e datës 27.08.2019; i kandidatëve të intervistuarl Vendimi - aprovohet procesverbali i listës definitive të kandidatëve, me nr.2969, i datës 28.08.2019; Kontrata për punë praktike në kohë të caktuar me nr.3181, e datës 11.09.2019; e lidhur në mes të NPK Trafiku Urban dhe L.B, Shpallja e konkursit publik në gazetën Epoka e re; Njoftimi për mos vazhdimin e kontratës 04.01.2020, i cili i është dërguar L.B, njoftim ky i dërguar nga Kryeshefi Ekzekutiv L.R; janë prova që vërtetojnë pafajësinë e të akuzuarit, pasi që këto prova dëshmojnë se angazhimi në cilësinë e praktikantes së IT, në Trafikun Urban, në kohën që i referohen këto prova, e në të cilën si praktikante ishte zgjedhur bashkëshortja e të akuzuarit R.B, nuk kishte të bënte me asnjë veprim të akuzuarit dhe të gjitha këto akte në emër të TU, mbanin firmën e të dëmtuarit L.R.

Procesverbali i mbledhjes së bordit të drejtorëve i datës 09.12.2019.

3.4. Deklarimi i të akuzuarit

3.4.1 I akuzuari R.B, ka shfrytëzuar të drejtën ligjore dhe është mbrojtur në heshtje dhe ka deklaruar se qëndron pranë deklaramëve të tija të dhëna në polici dhe në Prokurori.

4. Elementet e veprës penale

Në paragrafin 1 të nenit 417 është paraparë forma themelore e veprës penale të Konfliktit të interesit sipas së cilës dispozitë këtë vepër penale e kryen: “Personi zyrtar i cili merr pjesë

personalisht në ndonjë çështje zyrtare për të cilën e ka ditur apo është dashur ta dijë se ai apo ajo, ndonjë anëtar i familjes së tij ose të saj, ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të, ka interes financiar, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Ndërsa, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar: “Për qëllime të këtij neni, shprehja “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit, mbikëqyrjes, administrimit, likuidimit, pagesës ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit të padrejtë për një çështje zyrtare.

Ndërsa, paragrafin 4 i nenet të lartcekur ka përcaktuar, “Për qëllime të këtij neni, shprehja “çështje zyrtare” nënkupton procedurë gjyqësore ose procedurë tjetër zyrtare; aplikim, kërkesë për vendim ose përcaktim tjetër zyrtar; kontratë apo kërkesë; ankand publik ose veprim tjetër i prokurimit; ose ndonjë çështje tjetër e cila prek interesat financiare të personit zyrtar, anëtarit të familjes apo ndonjë personi juridik që ka të bëjë me të”.

Lidhur me veprën penale të konfliktit të interesit, kryerësi, merr pjesë personalisht në një çështje zyrtare, në të cilin ai apo ndonjë anëtar i familjes ka interes financiar, edhe atë duke e ushtruar autoritetin e tij zyrtar, përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit, mbikëqyrjes, administrimit, likuidimit, pagesës ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit të padrejtë për një çështje zyrtare, e që në rastin konkret Prokuroria të pandehurin e ka akuzuar se, i njëjti me dashje merr pjesë personalisht në çështjen zyrtare ku e ka ditur se bëhet fjalë për bashkëshorten e tij L.B, kështu që ka ushtruar autoritetin zyrtar duke i rekomanduar dhe këshilluar në vazhdimësi, nga muaji shtator e deri në muajin dhjetor të vitit 2019, ka kërkuar nga vartësi i tij tani i dëmtuari L.R, i cili kishte pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në ndërmarrjen e lartcekur, përmes komunikimeve verbale dhe elektronike. e veçanërisht përmes sms-ve në "WhatsApp", ashtu që i dëmtuari t’ia punësojë bashkëshorten e të pandehurit L.B në këtë ndërmarrje, ku ishte e angazhuar si praktikante nga ana e Entit për Punësim, fillimisht ka kërkuar që të hapet konkursi për pozitën e Zyrtarit të IT, e pas shpalljes së konkursit, ka insistuar dhe drejtuar kanosje që bashkëshortja e tij të punësohet në konkursin e lartcekur, e kur i dëmtuari me datë 23.12.2019, ka marrë vendim për anulimin e konkursit, i pandehuri ka filluar iniciativën për shkarkimin e tij duke e bërë gati draftin e vendimit për shkarkimin e tij si dhe është kanosur se do e rrah të dëmtuarin, e që në rastin konkret, nga provat e administruara nuk është vërtetuar fakti se, në veprimet e të akuzuarve janë manifestuar elementet e veprës penale të Konfliktit të interesit, për të cilën arsye Gjykata të njëjtit i liroi nga akuza.

5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Nuk ishin kontestuese faktet se bashkëshortja e të akuzuarit R.B, L.B, ishte praktikante e IT, në trafikun Urban, se i dëmtuari L.R, kishte hapur konkurs për IT, në Trafikun Urban. Gjithashtu, nuk kishte kontestues fakti se bashkëshortja e R.B, L.B kishte aplikuar për atë pozitë pas hapjes së konkursit, të tillë.

Kontestuese ishin faktet, nëse i akuzuari e kishte punësuar bashkëshorten e tij si praktikante fillimisht e pastaj, ta punësoj po në Trafikun Urban, në pozitën e IT, me konkurs të rregullt.

Gjykata, pas analizimit me shumë kujdes të gjitha provave të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se me asnjë provë personale apo materiale, nuk janë vërtetuar veprimet e të akuzuarit sikurse në dispozitivin e aktakuzës, se i njëjti ka kryer veprën penale me të cilën është akuzuar. Gjykata, vlerëson se, të gjitha provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, vërtetuan faktin se i pandehurit, nuk është kryerës i veprës penale Konflikt i interesit nga neni 417 par.1,3 dhe 4 të KPRK-së.

Siç është cekur më lart, për të ekzistuar vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, duhet që veprimet e marra nga i pandehuri të ketë shfrytëzuar autoritetin zyrtar duke rekomanduar dhe këshilluar tani të dëmtuarin L.R, që t'ia punësojë bashkëshorten e të pandehurit L.B në këtë ndërmarrje, ku fillimisht kishte kërkuar që të hapet konkursi për pozitën e Zyrtarit të IT, e pas shpalljes së konkursit, ka insistuar dhe drejtuar kanosje që bashkëshortja e tij të punësohet në konkursin e lartcekur, e kur i dëmtuari me datë 23.12.2019, ka marrë vendim për anulimin e konkursit, i pandehuri ka filluar iniciativën për shkarkimin e tij duke e bërë gati draftin e vendimit për shkarkimin e tij si dhe është kanosur se do e rrah të dëmtuarin. Duke ju referuar kësaj pike, Gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale, absolutisht nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se i akuzuari, të ketë kërkuar nga i dëmtuari fillimisht shpalljen e konkursit për IT të TU, me qëllim që të punësohet bashkëshortja e tij, L.B.

Nga provat që janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, edhe atë nga dëshmia e të dëmtuarit dëshmitarit, L.R, nuk vërtetohet teza e akuzës se i akuzuari, kishte ndërmarr veprimet inkriminuese siç përshkruhen në aktakuzë. Kjo për faktin se, dëshmia e dëshmitarit L.R, është kontradiktore me vetveten, edhe atë i njëjti njëherë deklaroi se ka pasur presion nga ia akuzuari për punësimin e gruas së tij (të akuzuarit) e në anën tjetër ka deklaruar se, R.B, nuk i kishte thënë drejtpërdrejt që t'ia punësojë gruan, por, këtë dëshmitari e kishte nxjerr nga

konteksti. Po ashtu, pretendimin e tij, e rrëzon vet deklarimi i tij, pasi që i njëjti ka deklaruar se, bashkëshortja e të akuzuarit si praktikante e IT, në TU, ishte punësuar përmes Agjencionit për Punësim, e të cilën përzgjedhje e kishte aprovuar ai vet, duke e nënshkruar dhe aprovuar atë përzgjedhje, duke e formalizuar atë punësim me kontratën e nënshkruar nga ai vet në një rën anë si dhe nga dëshmitarja L.B (bashkëshortja e të akuzuarit) në anën tjetër. Dhe ishte vet ai që i kishte kërkuar atij Agjencioni, që të aprovojë kërkesën e tyre për punësimin e një praktikant të IT, në TU, për shkak të nevojave imediate. Ky fakt vërtetohet nga prova materiale, Kërkesa e Trafikut Urban e datës 22.08.2019, drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, me të cilën shkresë i kanë kërkuar që t'i mundësohet angazhimi i një personi për punë praktike në N.P.K "Trafiku Urban" SH.A, për një periudhë kohore së paku 6 muaj, për nevoja të Teknologjisë Informative në Departamentin e Financave, me orar të rregullt të punës. Si dhe i kanë paraqitur në te kushtet që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozitë. Dhe duke e analizuar dëshminë e këtij dëshmitari, ku i njëjti kishte deklaruar se, sjellja e L.B në lokal "NEST" në të cilin takim ishte edhe i akuzuari R.B, ku L.B, i kishte bërë me gisht dhe gjestikulacion, e kishte bërë të ndjehet keq, por, që ai kishte kthyer kokën nga i akuzuari R.B, për të parë reagimin e tij, dhe kur e kishte parë që ai nuk po reagon, por, ishte perceptim i tij (L.R) se ai e mbështeste gruan e tij, e të cilën sjellje të L.B ai e kishte marr si kërcënim. Prandaj, shtrohet pyetja, nga kush ishte i kërcënuar ai, nga R.B, siç pretendohet në aktakuzë apo nga sjellja gjestikulative e L.B??? Po ashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari vërtetohet pafajësia e të akuzuarit edhe për faktin se, ai kishte deklaruar se, nga R.B, nuk kishte pasur kërcënim në aspektin fizik, por ishte ndjerë i kërcënuar me humbjen e vendit të punës, pasi që ekziston një nen në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, sipas të cilit Bordi mundet ta shkarkojë kryeshefin në çdo kohë, e që nga ky deklaram, vërtetohet fakti se i akuzuari nuk kishte pasur kompetencë që vet ta shkarkojë për çfarëdo arsye qoftë të dëmtuarin, i cili në atë kohë kishte mbajtur postin e Kryeshefit ekzekutiv, por, sipas kësaj dispozite që ai e ka cekur, kjo kishte qenë kompetencë ekskluzive e Bordit, dhe rrjedhimisht deklarimi i dëshmitarit si për këtë arsye e ka ndjerë veten të kërcënuar me humbje të vendit të punës nga i akuzuari, është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm. Për më tepër, kur analizohet dëshmia e tij në thelb, se si ai kishte pritur reagimin e të akuzuarit, pasi ai ishte ndjerë i kërcënuar nga bashkëshortja e të akuzuarit, respektivisht, siç e quan ai, praktikantja e angazhuar, sepse, sipas tij, me atë vrazhdësi që e kishte shikuar, ai e kishte perceptuar si një lloj kërcënimi dhe me të njëjtën i kishte shmang kontaktet, pasi që edhe korridoret në ndërmarrje ishin shumë të ngushta, ndërsa, asnjëherë nuk kishte paraqitur rastin në Polici, për këtë kanosje të pretenduar nga bashkëshortja e të akuzuarit, fundja, çdo kush përgjigjet për veprimet e veta dhe në rastin konkret veprimet e L.B, nuk mund të i veshën të akuzuarit R.B,

dhe deklarimi se ai kishte kthyer kokën nga i akuzuari për të parë reagimin e tij, kur bashkëshortja e tij, e kishte bërë të ndjehet jo mirë, bile edhe i kërcënuar, më shumë asocojnë në ndjesinë e mospërfilljes të të dëmtuarit, i cili si Kryeshef ekzekutiv në atë kohë ishte ndjerë i papërfillur nga praktikantja siç e quan ai, bashkëshorten e të akuzuarit, L.B. Dhe kjo vërtetohet edhe nga deklarimi i tij, se, duke parë eskalimin e situatës si kryeshef ekzekutiv, kishte marrë vendim për mbyllje të konkursit meqë mbyllja ishte në kompetencat e tija, ndërsa, përzgjedhja e kandidatëve nuk ishte në kompetencat e tija, por, ishte në duar të komisionit përzgjedhës. Dhe ai, nuk e kishte pritur kohën për formimin e komisionit përzgjedhës kishte marr vendim për mbylljen e konkursit. Ky deklarim i këtij dëshmitari, se nuk kishte pritur kohën për formimin e komisionit përzgjedhës, është jo i saktë, pasi që i njëjti është në kundërshtim po me deklarin e tij, të dhënë në gjykatë, pasi që, lidhur me arsyet e ndërprerjes së konkursit, ka deklaruar: “Unë kisha kërkuar nga anëtarët e komisionit, që të më njoftojnë me numrin e kandidatëve që janë paraqitur për atë pozitë dhe nëse nuk gaboja kanë qenë vetëm dy kandidatë të tjerë dhe gruaja e R.B. Sa i kujtohet kanë qenë vetëm tre kandidatë. Për dy kandidat që ishin që punonin në ndërmarrjen KOST, ku ishte i punësuar R.B dhe atij i kishte shkuar mendja se R.B, nga pozita e Drejtorit të Bordit, kur e merr punën komisioni, mundet me pas ndikim dhe te përzgjidhet pastaj gruaja e tij, dhe ai kishte pasur kompetenca të ndërhyjë te çështjet e komisionit dhe paraprakisht kjo ishte arsyeja që ai e kishte anuluar konkursin”. Ky deklarim bie ndesh edhe me provën materiale, edhe atë, Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës i datës 12.12.2019; me të cilin vendim është themeluar Komisioni përzgjedhës i aplikacioneve për procedurat e rekrutimit për pozitën Zyrtar i IT, në përbërje prej: V.K, Sh.M dhe M.I. Ndërsa, sa i përket mesazheve të cilat ai i quan kërcënuese, si: “ Vij dhe i thyej zyrat, ju kthej prape në shkollë ku dëshmitari lidhur me to ka sqaruar se, me këtë ka dashtë të shtrij autoritetin e tij, por fundja këto nuk janë elemente përbërëse te veprës penale të Konfliktit të interesit, për të cilën e akuzon Prokuroria. Ndërsa, Prokuroria, në mënyrë eksplicite e ka klasifikuar si vepër penale të konfliktit të interesit, e të cilat veprime sipas Prokurorisë kanë konsistuar, në formë të këshillimit dhe rekomandimit, por, pa shpjeguar qartë dhe pa provuar se, cilat ishin ato këshillime apo rekomandime. Kjo për faktin se ky dëshmitar në dëshminë e tij ka theksuar, R.B, nuk ka kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejt t’i punësohet gruaja e tij. R.B, nuk kishte pasur kompetencë të hap konkursin e as të formojë Komisionin, të gjitha këto ishin kompetencë ekskluzive e Kryeshefit Ekzekutiv, në rastin konkret dëshmitarit L.R, ndërsa, ka deklaruar se, i akuzuari nuk ka pasur kompetencë që të hap konkursin, por, mundet vetëm për të dhënë si këshillë apo rekomandim, prandaj është pikërisht ky fakt për të cilin Prokuroria e ka akuzuar të pandehurin, për këshillim dhe rekomandim, ndërsa, i dëmtuari ka deklaruar se ai kishte pasur ligjërisht këtë të drejt, së paku ai e kishte marrë vetëm

si të tillë, por pa pasur kompetencë të ndikojë në vendim marrje dhe kjo atij nuk i kishte penguar edhe sikur të kishte vepruar ashtu, por atij realisht i kishte penguar pse i akuzuari, nuk kishte reaguar kur bashkëshortja e tij, nuk ishte sjell mirë me të, në kafiterinë “NEST”. Ndërsa, ishte jo bindëse për gjykatën, deklarata e të dëmtuarit përkitazi me argumentimin e tij, për përfshirjen e të akuzuarit në veprën penale që i vihet në barrë, edhe atë arsytet e dhëna nga i dëmtuari për anulimin e konkursit se, ai mendonte se personat që kishin aplikuar, e që sipas tij ishin punëtor të KOST, ku edhe punonte edhe i akuzuari R.B, e që sipas bindjes së tij ata me direktiva të akuzuarit kishin aplikuar vetëm për të përmbushur kriteret ligjore në favor të bashkëshortes të tani të akuzuarit R.B, L.B, pasi që ato kanë mbetur vetëm në suaza të indiceve të perceptuara nga ai vet, por pa i argumentuar me asnjë provë konkrete. Ndërsa, fakti që i referohet i dëmtuari sa i përket ngritjes së pagave të të punësuarve, e që e lidh me konkursin e bashkëshortes të të akuzuarit, është jashtë çdo ndikimi përkitazi me veprimet e të akuzuarit të cilat i janë venë barrë nga Prokuroria, pasi që nuk ka qenë ai vendimmarrës për ngritjen apo uljen e pagave të punëtorëve të Trafikut Urban dhe është më se e qartë se Bordi i trafikut Urban, ka vepruar si trup kolegjal dhe vendimet i ka marrë në një format të tillë e në asnjë formë apo mënyrë nuk ka pasur mundësi që të vendos i akuzuari R.B, i vetëm, për cilën do arsye qoftë, thjeshtë ai vetëm ka udhëhequr me Bordin, por, vendimet janë marrë në mënyrë kolegjinale. Dhe për më tepër i dëmtuari përkitazi me këtë fakt ka deklaruar se, saktësisht nuk i kujtohet t’i ketë thënë se, nëse nuk do të punësohej gruaja e tij do të zbriteshin pagat. Po ashtu, edhe deklarimi i të dëmtuarit përkitazi me denoncimin e të akuzuarit se, pas anulimit të konkursit R.B, kishte kërkuar që, shumica e të punësuarve të dërgojnë raporte te punës direkt tek kryesuesi i Bordit dhe këtu e kishte kuptuar një degradim të pozitës së tij, jep të kuptohet se i dëmtuari në vazhdimësi, vëmendjen dhe fokusin e ka tek pozita e tij, dhe se nuk kishte qenë qëllimi i tij real, ai i luftimit të nepotizmit, apo konfliktit të interesit siç akuzohet nga Prokuroria. Shtrohet pyetja, nëse i dëmtuari e kishte konsideruar se i akuzuari kishte bërë presion tek ai për të publikuar konkursin, në mënyrë që t’i punësohej bashkëshortja e tij, L.B, atëherë pse i njëjti nuk e kishte denoncuar menjëherë rastin tek organet e rendit, por, kishte shpallur konkursin, kishte marrë vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e aplikacioneve. E tek më pas, pasi kishte shprehur interesim, tek Komisioni, se kush janë kandidatët dhe kishte marrë informata tjera se ku punonin, kishte anuluar konkursin, edhe atë pa dhënë arsye konkrete dhe të qarta, por duke u munduar ta arsyetojë atë veprim kinse me presionin e ushtruar nga i akuzuari, me marrjen në dijeni se kush ishin aplikantët, e fakte tjera të mbështetura vetëm në hipotezën e tij të dyshimit, e duke i përdorur të gjitha këto si argument për të akuzuar të pandehurin, ndërsa, nga sms në platformën Whsaap, ishte po ai që i kishte shkruar me datë 24.07.2019 ora 09:11 minuta e 55 sekonda të

akuzuarit R.B, “ ” Na po vazhdojmë me punë....puna flet vetë. Flm për mbështetjen, sa te kryej rastin du me marrë L.B, se nuk ka çka me ndodhe, folët dy tri ditë dhe harrohet ajo punë”. Po ashtu, para gjykatës përkitazi me arsyet e hapjes së konkursit ka deklaruar se, konkursin nga pozita e kryeshefit ekzekutiv e kishte marrë nga nevoja imediate që e kishin pas në ndërmarrje. Shpesh nuk kishin mundur te komunikojnë me emaila zyrtar dhe ishte dashur te komunikojnë me emaile private. Në publikimet ne Webfaqe për transportin publik, mungonte zyrtari përgjegjës me njohuri për këtë çështje, apo çështje të tjera të IT, si instalimi i kompjuterëve, softuerëve brenda administratës. Konkursi është hap për shkak të nevojës, si dhe kishte deklaruar se, së bashku me Bordin e kishin vendosur në strukturën organizative edhe pozitën e zyrtarit për IT dhe për zyrtarë të IT, ka qenë kërkesë e brendshme e administratës. Ai vet e ka pohuar se L.B, ka pas të përfunduar shkollimin për IT.

Po ashtu, duke e vlerësuar deklaratën e këtij dëshmitari, në mënyrë të plotë e të gjithanshme vërtetohet pafajësia e të akuzuarit, edhe atë i njëjti, ka deklaruar gjithashtu se, R.B, nuk ka kërkuar drejtpërdrejt punësimin e gruas së tij, por ka aluduar në punësimin e gruas së tij, të cilin aludim e ka nxjerr nga konteksti i shprehjeve: “Hapeni konkursin, mos pritni më”, pastaj “ pagat mund të zbriten”. Po ashtu, pafajësia e të akuzuarit vërtetohet nga deklarimi i këtij dëshmitari, edhe nga pjesa e deklarimit të tij, ku kishte theksuar se, pas takimit në kafiterinë NEST, me R.B, kishin vazhduar komunikimet për çështje të ndërmarrjes dhe nga i cili kishte kërkuar vazhdimisht të takohet për tu sqaruar për atë presion. Në një rast R.B, me sms i kishte thënë “ tu ka nxeh koka dhe kur të ftohesh, takohemi”. kjo i ishte thënë. Ku po atë ditë në ditën pas takimit në NEST, me datë 13.12.2019 në ora 13:58, i dëmtuari i kishte dërguar një email në adresë të akuzuarit R.B, ku i ishte referuar takimit te mëngjesit në NEST, të diskutimeve që kishin pasur me R.B dhe L.B dhe ndër të tjera kishte deklaruar si në vijim: “na ndodhi kjo çështje sot, tuj mendu për ma mirë dhe se unë kam folë shlrë dhe pa protokoll në aspektin miqësor, për këtë temë nuk kisha pas qef me ditë D. dhe F., ju e gjykoni vet mirëpo e shoh te arsyeshme që të përmendi se keq kuptimet tona mos ti dijnë ata. Qëllimi im ishte me bisedu që le të ndihet krenare dhe mos të ketë brenga se proceset zhvillohen por nga pakujdesia ime.. është prodhuar efekti i kundërt dhe me vjen shumë keq për L.B se është nervozuar.”. Pra, nga ky email vërtetohet se, atë ditë i dëmtuari nuk kishte pasur asnjë kërcenim nga bashkëshortja e të akuzuarit L.B dhe rrjedhimisht as nga ky i akuzuar, dhe se pohimi i tij se i ishte frikësuar autoritetit të të akuzuarit, është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, sepse siç u cek më lart, atë nga pozita e kryeshefit ekzekutiv, vetëm Bordi i Trafikut Urban, ka pasur kompetencë që ta shkarkojë dhe jo vetëm i akuzuari. Kontradita e dëshmisë së këtij dëshmitari vije në shprehje edhe përkitazi me deklarimin e tij se, punësimi bëhet mbi bazën e meritave dhe ato merita vlerësohen nga komisioni vlerësues. Por që

realisht ishte vet ai që nga komisioni vetëm kishte kërkuar të dhëna për numrin dhe emrat e kandidatëve, që do të thotë, ai vet kishte interferuar përmes të dhënave që i kishte marrë nga Komisioni, sipas kërkesës së tij, në dosjet e kandidatëve, përkundër faktit se ai e mohon këtë gjë, por që kjo vërtetohet nga vet dëshmia e tij, ku ka deklaruar se, konkursin e kishte anuluar pasi kishte kuptuar se, kush janë dy kandidatët tjerë e që sipas tij, ishin punëtor të KOST, ku punonte edhe i akuzuari R.B dhe kishte menduar se i akuzuari iu kishte kërkuar atyre që të konkurrojnë për pozitën e zyrtarit të IT, sa për të plotësuar anën formale për shkak të bashkëshortes të tani të akuzuarit R.B.

Prandaj, gjykata duke e vlerësuar dëshminë e këtij dëshmitari në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme ndërlidhur edhe me provat tjera, erdhi në përfundim se e njëjta nuk provon fajësinë e të akuzuarit R.B, përkitazi me veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata duke i'u referuar dispozitës me të cilën përshkruan veprimet lidhur me veprën penale të Konfliktit të interesit nga neni 417 të KPRK-së, se në cilësinë e personit zyrtar të ketë marrë pjesë personalisht në çështjen zyrtare, konkretisht në punësimin e bashkëshortes së tij L.B, duke e këshilluar dhe rekomanduar, të dëmtuarin- dëshmitarin L.R, që ta punësojë bashkëshorten e tij, edhe atë fillimisht e kishte këshilluar që ta hapte konkursin, për pozitën e Zyrtarit të IT, në ndërmarrjen e Trafikut Urban, kjo nuk është vërtetuar pasi që vet ky dëshmitar ka deklaruar se, i pandehuri nuk i kishte thënë drejtpërdrejt asnjëherë të hapte konkurs për pozitën e IT, në mënyrë që të punësohej bashkëshortja e të akuzuarit, për më tepër kjo kishte qenë e planifikuar më parë, dhe për këtë ka edhe komunikime në mes të këtij dëshmitari dhe dëshmitarit D.M, ku kërkohej që në mënyrë urgjente duhet të hapej konkursi për atë pozitë, pasi që Trafiku Urban kishte nevojë urgjente për këtë, pasi siç është cekur në ato komunikime edhe emaillet mes vete i shkëmbejnë ne emaile private, pasi që nuk kishte kush të merrej me ato zyrtare, por edhe punë tjera të domosdoshme të zyrtarit të TI. Pra, kjo e rrëzon tezen e akuzës se i akuzuari kishte këshilluar dhe rekomanduar, bile edhe përmes presionit dhe kërcimeve ndaj të dëmtuarit- dëshmitarit L.R, që t'i punësohej bashkëshortja në Trafikun Urban, rrethanë kjo e cila kategorizohet si njëra nga elementet që nuk e ka përmbushur figurën e veprës penale të konfliktit të interesit, e cila veprë i ishte venë në barrë të akuzuarit.

Po ashtu, pafajësia e të akuzuarit R.B, vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit, D.M i cili ka deklaruar se, L.B, ishte punësuar si praktikante e TI, në Trafikun Urban, përmes Agjencisë për Punësim. Ai ka deklaruar se, i dëmtuari – dëshmitari L.R, i kishte thënë se tani i akuzuari R.B, i kishte bërë presion për hapjen e konkursit për tu punësuar bashkëshortja e tij, L.B, por, këtë nuk e kishte dëgjuar ai vet. Si dhe ka deklaruar se, nuk e din se çka ishte biseduar përpara hapjes së

konkursit. Ndërsa, deklaratën e tij që e kishte shkruar në kompjuter për Polici, i ishte kërkuar nga i dëmtuari – dëshmitari L.R, e cila deklaratë ishte për paraqitjen e të akuzuarit R.B, për veprën penale që i vihet në barrë. Po ashtu, nga deklarata e këtij dëshmitari, nuk mund të vërtetohet asnjë fakt i pretenduar nga i dëmtuari- dëshmitari L.R, që kishte ndodhur në kafiterin ku R.B me L.B, kanë qenë në drekë, pasi që i njëjti nuk kishte qenë prezent. Po ashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari vërtetohet fakti se, i akuzuari R.B, nga mllefi i aty për atyshëm kishte thënë se “vij e rrehi L.R, ia thej xhamat”, dhe pikërisht për shkak të kësaj situate të tensionuar ai kishte shkuar për të biseduar me R.B. Po ashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari vërtetohet fakti se, me datë 23.12.2019, i dëmtuari - dëshmitari L.R, i kishte thënë që ka marrë vendim me anulim konkursin, e që për kishte pasur një justifikim se kanë aplikuar edhe disa të tjerë, e për të cilët i kishte treguar sigurisht dëshmitari, sepse ai nuk kishte pasur informata për ata kandidatë. Ndërsa, deklarimi i këtij dëshmitari se, i akuzuari R.B, i kishte shkruar sms dhe i kishte thënë “e paska anulim konkursin e L.B” dhe ka aludu në L.R, nuk mund të vërtetohet fajësia e të akuzuarit, pasi që konkursi ishte i hapur për të gjithë, dhe aty kanë pasur të drejtë të aplikojnë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, përfshirë këtu edhe bashkëshorten e të akuzuarit R.B, sepse këtë të drejtë ia njeh Kushtetuta e Republikës së Kosovës, edhe atë në nenin 49 par.2 të saj është garantuar e drejta për punë, ku në mënyrë eksplicite proklamohet “ Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”, prandaj edhe në rastin konkret, meqenëse bashkëshortja e të akuzuarit R.B, L.B, ka plotësuar kushtet ligjore për atë pozitë, për të cilën ishte hapur konkursi, ka pasur të drejtë që të aplikojë, dhe nuk është diçka e veçantë në këtë rast, pasi që edhe në Institucionet tjera, ka të punësuar në të njëjtin Institucion, anëtarë të familjes, si: bashkëshortë, prindër fëmijë, vëlla motër, motër motër, apo edhe raporte tjera familjare dhe fundja në rastin konkret, i akuzuari, nuk ka pasur kompetencë të vendos, lidhur me hapjen e konkursit, apo përzgjedhjen e kandidatëve, e as për anulimin e tij, dhe se i dëmtuari, në asnjë moment nuk kishte paraqitur rastin ndaj të akuzuarit R.B, tek organet e rendit më herët, kur pretendon se ishte këshilluar, rekomanduar, kanosur që të shpallte këtë konkurs, por, tek pas anulimit të tij, e të cilin sipas deklaramit të tij e kishte bërë pasi që ishte “kanosur”, nga bashkëshortja e të akuzuarit L.B, e për të cilin veprim të saj, nuk kishte reaguar fare i akuzuari R.B. Ndërsa, nga dëshmia e këtij dëshmitari, nuk mund të vërtetohet fakti se i akuzuari R.B, të ketë kërkuar nga F.T, që të përgatitet një vendim për shkarkimin e L.R, pasi që këtë vet nuk e kishte parë as dëgjuar, por, kishte dëgjuar në komunikim nga të tjerët, nuk mundet me ditë kush kanë qenë ata. Nga dëshmia e këtij dëshmitari vërtetohet pafajësia e të akuzuarit edhe për faktin se i njëjti ka deklaruar se, kishin bërë vlerësim të nevojave të Departamentit të Financave për zyrtar të IT, dhe kanë pasur nevojë dikush me iu ndihmuar në Zyrën e Financave. Si dhe që kanë

pasur nevojë për zyrtar të IT-së tek Financat, pasi nuk kanë pasur të tillë. Si dhe ka pohuar faktin se, me komunikimet përmes emailit i ishte drejtuar Kryeshefit Ekzekutiv L.R, përmes emailit zyrtar, me datë 05.12.2019, në ora 15:28, dhe emailin e dytë të së njëjtës datë, në ora 14:50, përmes të cilave kishte kërkuar hapjen e konkursit për zyrtar të IT-së në Departamentin e Financave, dhe e kishte elaboruar nevojën për një zyrtar të IT-së, si dhe pohimi i tij, se, nevojën për një zyrtar të IT-së, ai vet e kishte elaboruar në mbledhjen e Bordit të Trafikut Urban dhe pas mbledhjes së Bordit, ishte hapur konkursi sipas kërkesës së tij, për zyrtar të IT. Por, ai nuk ka qenë anëtar i Komisionit për përzgjedhjen e punëtorit të IT, e as nuk e kishte njohur ndonjërin nga kandidatët që kanë aplikuar për pozitën e IT, e sidomos fakti se, kishte deklaruar se: nuk ka pasur kërkesë urdhëruese nga R.B për shpalljen e konkursit. Po ashtu, nga deklarimi i këtij dëshmitari vërtetohet fakti se i dëmtuari – dëshmitari L.R, në atë kohë i kishte marrë gjërat me tension dhe pa maturi, për çka edhe i kishte tërhequr vërejtjen të akuzuarit, për maturi, ku kishte ndërmjetësuar në raportet mes tij dhe të dëmtuarit L.R. Prandaj, në një situatë të tillë gjykata medoemos e zbaton parimin in dubio pro reo, respektivisht mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit.

Po ashtu, nga dëshmia e dëshmitarit F.T, nuk vërtetohet teza e akuzues se i akuzuari kishte kryer veprën penale që i vihet në barrë, kjo për faktin se, i njëjti ka deklaruar se, R.B nuk i kishte thënë asgjë atij për konkursin, por, i njëjti i kishte kërkuar përpilimin e një mostre të vendimit për shkarkim të në atë kohë kryeshefit ekzekutiv L.R, por që arsyet nuk ia kishte thënë dhe se nuk i kujtohet data e as koha kur kishte ndodhur kjo, e as mënyra e kërkesës, përmes telefonit apo ndryshe. Sidomos faktin se, siç kishte deklaruar se, zakonisht draft-shkresat e Bordit të ndërmarrjes i përpilon sekretari i ndërmarrjes, e të cilat Bordi edhe mund t'i ndryshojë, por që ky draft vendim nuk kishte dalur asnjëherë në Bord dhe nuk e din se çfarë ka ndodhur me atë vendim. Deklarimi i këtij dëshmitari përkitazi me këtë fakt në plotëni vërteton pafajësinë e të akuzuarit, pasi që i njëjti ka deklaruar se, është e vërtetë se draft-vendimi të cilin e ka përpiluar sipas kërkesës së R.B, nuk ka përmbajtur as emër, as mbiemër të askujt e as pozitën e personit dhe as arsyet e shkarkimit, ka qenë vetëm një formë dhe një bazë ligjore se si shkarkohen zyrtarët e lartë në përgjithësi në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Draft-vendimi i përpiluar nga ai mund të shërbejë si formë për shkarkimin e secilit zyrtar të lartë, përveç që duhet me i përshtat arsyet dhe të gjendet baza ligjore. Në atë draft-vendim kanë qenë të gjitha bazat ligjore për shkarkimin e zyrtarëve ligjorë dhe varësisht nga arsyeja mund të merret baza ligjore përkatëse. Nuk i kujtohet koha kur është kërkuar nga ai përpilimi i një draft-vendimi, a ka qenë para apo pas anulimit të konkursit, por nuk e di se a ka pasur drafti datë. Si dhe ka shtuar se, të gjitha

vendimet e Bordit të ndërmarrjes duhet të kalojnë me shumicë votash, kështu e parasheh ligji. Prandaj, deklarimi i këtij dëshmitari, nuk mund të merret si i mirëqenë, se i akuzuari R.B, t'i ketë kërkuar këtij dëshmitari, hartimin e vendimit për shkarkim të Kryeshefit Ekzekutiv të TU, në rastin konkret L.R, pasi i njëjti nuk e din, kohën, mënyrën, e as faktet e rëndësishme që do ta bënin të besueshme këtë fakt. Po ashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari, nuk vërtetohet teza e akuzës, se i akuzuari i kishte bërë presion të dëmtuarit dëshmitarit, pasi që i njëjti në mënyrë eksplicite ka deklaruar se, nuk e din se i dëmtuari, prej kujt ka pasur presion lidhur me konkursin. Po ashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari, vërtetohet fakti, se në TU kanë pasur nevojë për një zyrtar të IT, pasi që nuk ka pasur zyrtar të tillë në ndërmarrje dhe se, të nijetit nuk i kujtohej nëse konkursin për IT, e kishte përgatitur sipas kërkesës së Kryeshefit, të dëmtuarit L.R, apo atë e kanë përgatitur Burimet njerëzore. Po ashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari vërehet fakti se i dëmtuari e kishte anuluar konkursin, pa pasur bazë ligjore, e të cilat ishin të parapara në Udhëzimin Administrativ 07/2017, i cili i parasheh në mënyrë decisive kriteret për anulimin e një konkursi.

Nga dëshmia e dëshmitarit G.B, të cilës dëshmia gjykata ia fali besimin, nuk vërtetohet teza e akuzës se i pandehuri R.B ka kryer veprën penale që i vihet në barrë. Kjo për faktin se i njëjti, ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni, për hapjen e as anulimin e konkursit, pasi që kjo nuk ka qenë kompetencë e Bordit. Si dhe faktit se, i dëmtuari i kishte thënë se, arsyet e anulimit sipas L.R kanë qenë se R.B, po i bënte presion, por ai nuk e kishte parë e as vërejtur nëse R.B, i ka bërë apo jo presion. Po ashtu, fakti që ai ka deklaruar se, është e drejtë e çdo qytetari të Republikës së Kosovës, që të aplikojë në të gjitha ndërmarrjet apo institucionet shtetërore pa diskriminim dhe si qytetar i lirë i Kosovës. Pranimi i praktikantëve nuk ka qenë përgjegjësi e Bordit të ndërmarrjes, Bordi e përzgjedh vetëm menaxhmentin e lartë dhe askënd tjetër, ndërsa praktikantët zgjedhën nga menaxhmenti përkatës i ndërmarrjes. Po ashtu, ky dëshmitar ka dëshmuar se, R.B, atij, asnjëherë nuk ia ka përmendur se dëshiron me punësua gruan në ndërmarrje. Si dhe ai nuk kishte dëgjuar, që R.B, i ka bërë presion dikujt që gruaja e tij L.B, të punësohet në ndërmarrje. Po ashtu nga dëshmia e këtij dëshmitari, nuk vërtetohet teza e akuzës se i pandehuri, ka dasht ta shkarkojë të dëmtuarin, L.R, për shkak të anulimit të konkursit, pasi që ky dëshmitar ka dëshmuar se, asnjëherë në mbledhje të Bordit nuk është diskutuar për shkarkimin e kryeshefit ekzekutiv L.R. Ndërsa, ka dëshmuar se, sipas tij, mbetet në suaza të spekulimit dyshimi, se i pandehuri R.B i kishte prishur raportet me Kryeshefin, të dëmtuarin L.R, për shkak të konkursit. Edhe nga dëshmia e këtij dëshmitari, vërtetohet fakti se bashkëshortja e të akuzuarit, L.B, ishte punësuar si praktikante në TU, nga Agjencioni për punësim, si dhe çdo

praktikant tjetër dhe zyrtarisht nuk kanë konstatuar se kjo përbën ndonjë shkelje etike. Tuje ka sqaruar se, praktikantët janë pranuar përmes Entit të Punësimit dhe ata nuk kanë pasur çasje në atë pjesë, pranimin e praktikantëve e ka bërë menaxhmenti bashkë me Entin e punësimit. Po ashtu, nga dëshmia e këtij dëshmitari vërtetohet fakti se, ndërmarrja TU, ka pasur nevojë për një zyrtar të IT-së, pasi që nuk ka pasur asnjë të tillë në ndërmarrje. Ndërsa, planin e menaxhimit të personelit e bën menaxhmenti me stafin që e kanë, ndërsa e aprovon Bordi dhe Bordi e aprovon vetëm pozitën por jo edhe punësimin e personit konkret. Pasi është bërë riorganizimi i ndërmarrjes, është bërë organogrami i ri dhe është aprovuar organogrami. Dhe se në Bord, ishte aprovuar pozita e zyrtarit të IT-së së ndërmarrjes, por e njëjta është aprovuar si paketë edhe me pozitën e tjera, pra, nga kjo rezulton se, nuk ka qenë rekomandim i të akuzuarit R.B, që të hapet konkursi për bashkëshorten e tij, siç pretendohet në aktakuzë.

Po ashtu, nga dëshmia e dëshmitares V.A.H, nuk vërtetohet teza e akuzës për veprën penale që i vuhet në barrë të akuzuarit R.B. Kjo për faktin se, e njëjta ka deklaruar se, Ajo kishte dëgjuar fjalë që bashkëshortja e R.B, ishte praktike në Trafikun Urban, por zyrtarisht nuk ka pasur asnjë informacion. Dhe si pjesë e Komisionit të Auditimit i përbërë prej 3 anëtarëve të Bordit, gjatë auditimit, nuk i kujtohet që kanë vërejtur ndonjë parregullsi në punësimin e praktikantëve, pra në rastin konkret as e bashkëshortes të të akuzuarit R.B. Po ashtu, nga dëshmia e kësaj dëshmitare, të cilës gjykata ia dal besimin, nuk vërtetohet teza e akuzës, se i pandehuri kishte dashur ta shkarkojë të dëmtuarin L.R, për shkak të anulimit të konkursit, pasi që e njëjta ka deklaruar se, në mbledhje të Bordit nuk i kujtohet që është diskutuar shkarkimi i kryeshefit të ndërmarrjes. E as nuk ishte në dijeni që kryesuesi i Bordit R.B, të ketë ushtruar presion ndaj dikujt për punësimin e bashkëshortes së tij në ndërmarrjen publike Trafiku Urban.

Dëshmitarja L.B, pas njoftimit nga Gjykata, për të drejtat e saja, nga neni 124 të KPP, për të u mos u deklaruar, nuk ka dhënë dëshmi në këtë çështje penale.

Ndërsa, nga deklarata e dëshmitares V.H, dëshmia e të cilës u lexua, pasi që e njëjta nuk ka mundur të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor, për shkaqe shëndetësore, nuk vërtetohet teza e akuzës se i akuzuari R.B, kishte kryer veprën penale që i vuhet në barrë. Kjo për faktin se, ajo nuk kishte pasur njohuri, nuk kishte njohuri lidhur me konkursin për zyrtar të IT. Ndërsa, për mbylljen e tij ishte njoftuar nga anëtari tjetër i Bordit G.B, i cili e kishte njoftuar rreth rastit si kishte ndodhur dhe pse ishte anuluar konkursi. E njëjta ka deklaruar se, raportet në mes të R.B dhe L.R, kanë qenë të mira dhe se nuk ka dijeni për mosmarrëveshjet në mes tyre.

Po ashtu, pafajësia e të akuzuarit R.B, vërtetohet edhe nga provat materiale të administruara edhe atë, nga,

Komunikimet në Whatsapp në mes të të pandehurit R.B me të dëmtuarin L.R, si dhe me dëshmitarin D.M; nga të cilat komunikime,

Sa i përket provës materiale atë të Raportit të ekzaminimit të telefonit të të pandehurit, të datës 25.03.2019, në të cilin raport ceken komunikimet në mes të të pandehurit dhe të dëmtuarit, lidhur me sistemim në punë dhe kontratën e punës për bashkëshorten e të pandehurit, nga kjo provë nuk vërtetohet fajësia e të akuzuarit R.B, pasi që sipas aktakuzës veprimet e ndërmarra nga i akuzuari i referohen periudhës shtator e deri në muajin dhjetor të vitit 2019.

Ndërsa, provë tjetër materiale në këtë proces penal është edhe Vendimi për shpalljen e konkursit publik për vendin e punës zyrtar i IT, me nr. 4354, i datës 06.12.2019; me të cilin është shpallur konkursi publik për IT, e në të cilin definohej kushtet e kandidatëve. kualifikimi, paga dhe kohëzgjatja e kontratës, nuk provon fajësinë e të akuzuarit, pasi që, siç u cek më lart, që konkursi për këtë pozitë ishte kërkuar për shkak të nevojave të ndërmarrjes së TU, ku në dëshminë e tij dëshmitari D.M, e ka pohuar faktin se kërkesa për hapjen e saj ka qenë e Departamentit ku ai punon, respektivisht Departamenti i Financave, fakt i cili provohet edhe me shkresën, konkretisht emailin zyrtar të datës 05.12.2019, ku i njëjti dy herë gjatë kësaj dite, i kishte kërkuar të dëmtuarit L.R, që në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv në TU, të hap këtë konkurs, pasi që kjo ishte në kompetencë të tij, e jo sipas rekomandimit, këshillimit apo presionit të të pandehurit R.B, siç pretendohet në aktakuzë.

Po ashtu, nga prova materiale siç është Vendimi i datës 23.12.2019, për anulimin e konkursit publik për vendin e punës zyrtar i IT, me nr. 4355, të datës 06.12.2019, ku edhe janë dhënë arsyet për anulimin e konkursit, si në vijim: meqenëse janë të angazhuar dy zyrtarë për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, që kanë të bëjnë me IT, punësimi i këtij zyrtari mund të shtyhet; po ashtu është shtyrë edhe tenderi për “kamera dhe pajisje monitoruese” si dhe ka vlerësuar se marrë parasysh kandidatët të cilët kanë aplikuar, mund të ketë favorizime, nuk është provë që provon fajësinë e të akuzuarit, pasi siç shihet nga arsyet e dhëna, në asnjërën prej tyre nuk vërehet të jetë anuluar konkursi për shkak të, presionit të të akuzuarit R.B, për punësimin e bashkëshortes së tij në këtë konkurs.

Po ashtu, nga prova materiale, Njoftimi për anulimin e konkursit i datës 23.12.2019; me të cilin janë njoftuar kandidatët për anulimin e konkursit nr. 4355. i cit. 06.12.2019, nuk vërtetohet

fajësia e të akuzuarit R.B, për me tepër ky vendim është i paarsyetuar në tersi pasi që në te nuk janë cekur arsyet e anulimit të konkursit- nga ana e të dëmtuarit L.R.

Ndërsa, prova materiale, Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës i datës 12.12.2019; me të cilin vendim është themeluar Komisioni përzgjedhës i aplikacioneve për procedurat e rekrutimit për pozitën Zyrtar i IT, në përbërje prej: V.K, Sh.M dhe M.I, vetëm sa vërteton në mënyrë të plotë pafajësinë e të akuzuarit R.B, pasi që ky Komision ishte formuar nga vet i dëmtuari L.R, i cili edhe kishte mohuar ekzistimin e tij, kur kishte deklaruar se, e kishte anuluar konkursin, para se të formonte Komisionin.

Provë tjetër materiale në këtë proces penal është Drafti i vendimit për shkarkimin e zyrtarit, nuk provon fajësinë e të akuzuarit R.B, pasi që siç shihet kjo formë e vendimit, nuk përmban emër, mbiemër, datë pozitive apo diçka që e identifikon se kujt i dedikohet ky vendim, por thjeshtë është një draft formular për shkarkim të një zyrtari publik.

Po ashtu prova tjetër materiale, Emaili i datës 30.12.2019; me të cilin email, i akuzuari R.B, ka kërkuar nga L.R, që të dërgohen raportet javore si gjithmonë të pozitave të punës, si deri tani, nuk provon fajësinë e të akuzuarit R.B, pasi që i njëjti këto raporte i kishte kërkuar në suaza të punës, e jo për punësimin e bashkëshortes së tij, dhe kjo rrjedhimisht nuk paraqet veprë penale të konfliktit të interesit.

Po ashtu, nga komunikimet në Whatsapp në mes të të dëmtuarit L.R dhe të pandehurit R.B të datës 06.12.2019 dhe 23.12.2019, nuk provohet fajësia e të akuzuarit R.B, pasi që aty diskutohet çështje të ri sistemit të punëtorëve nëpër zyra të TU, çështje të pagave, si dhe vërehet një komunikim i tensionuar në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit, ku i dëmtuari i fillimisht i kishte sugjeruar që të flasin me zë, pasi kështu mund të keqkuptohen, por i akuzuari kishte refuzuar, më pas i dëmtuari e kishte kanosur me paraqitje në institucione përgjegjëse, për ta mbrojtur dinjitetin dhe integritetin e pozitës së tij, si KE në Trafik Urban, ndërsa, i akuzuari ia kishte kthyer se nuk janë kërcënime, dhe siç shihet nga kjo provë i dëmtuari i referohet pozitës së tij zyrtare, por që nga ky komunikim nuk vërehet asnjë lloj kërcënimi i të akuzuarit ndaj tij.

Ndërsa, nga komunikimin në WhatsApp në mes të akuzuarit R.B dhe dëshmitarit D.M, diskutohet lidhur me raportet e tensionuara në mes të dëmtuarit L.R dhe D.M, por që kjo provë në lidhëmeri edhe me provat tjera , nuk provon fajësinë e të akuzuarit R.B, pasi aty diskutohet për sjelljet e të dëmtuarit L.R, por që si e tillë nuk përmban elementet e veprës penale të Konfliktit të interesit.

Po ashtu, nga provat tjera materiale, Kërkesa e Trafikut Urban e datës 22.08.2019; për angazhimin e një praktikanti për punë të IT; Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës

me nr. 2914, i datës 23.08.2019; për angazhimin e një praktikanti për punë të IT në NPK Trafiku Urban në Prishtinë, Lista e distribuimit e datës 22.08.2019; nga enti i punësimit; Procesverbali i vlerësimit dhe lista definitive e kandidatëve e datës 27.08.2019; i kandidatëve të intervistuarl Vendimi - aprovohet procesverbali i listës definitive të kandidatëve, me nr.2969, i datës 28.08.2019; Kontrata për punë praktike në kohë të caktuar me nr.3181, e datës 11.09.2019; e lidhur në mes të NPK Trafiku Urban dhe L.B, Shpallja e konkursit publik në gazetën Epoka e re; Njoftimi për mos vazhdimin e kontratës 04.01.2020, i cili i është dërguar L.B, njoftim ky i dërguar nga Kryeshefi Ekzekutiv L.R; janë prova që vërtetojnë pafajësinë e të akuzuarit, pasi që këto prova dëshmojnë se angazhimi në cilësinë e praktikantes së IT, në Trafikun Urban, në kohën që i referohen këto prova, e në të cilën si praktikante ishte zgjedhur bashkëshortja e të akuzuarit R.B, nuk kishte të bënte me asnjë veprim të akuzuarit dhe të gjitha këto akte në emër të TU, mbanin firmën e të dëmtuarit L.R.

Po ashtu, provë materiale në këtë çështje penale është edhe Procesverbali i mbledhjes së bordit të drejtorëve i datës 09.12.2019; por që i njëjti nuk provon asgjë sa i përket fajësisë të të akuzuarit.

Ndërsa, me provën materiale, Njoftimi i datës 04.01.2020, nuk mund të vërtetohet fajësia e të pandehurit, pasi që ky njoftim, vetëm vërteton faktin se, i dëmtuari L.R, në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv të TU, ka pasur kompetencë të nënshkruajë kontratën lidhur me angazhimin e stafit të administratës në TU, e në këtë rast të praktikantes L.B, si dhe të ndërpresë kontratën siç ka vepruar në rastin konkret, dhe propozimi i Prokurorisë si provë të një prove si kjo, jo vetëm që është i pakuptimit por edhe absurd, pasi që, qartazi shihet se kjo provë në asnjë formë dhe asnjë mënyrë nuk ndërlidhet me veprimet e të akuzuarit R.B, dhe provë si kjo janë edhe: Procesverbali i mbledhjes së bordit të drejtorëve i datës 09.12.2019; Kërkesa e Trafikut Urban e datës 22.08.2019; për angazhimin e një praktikanti për punë të IT; Vendimi për themelimin e komisionit përzgjedhës me nr. 2914, i datës 23.08.2019; për angazhimin e një praktikanti për punë të IT në NPK Trafiku Urban në Prishtinë, Lista e distribuimit e datës 22.08.2019; nga enti i punësimit; Procesverbali i vlerësimit dhe lista definitive e kandidatëve e datës 27.08.2019; i kandidatëve të intervistuarl Vendimi - aprovohet procesverbali i listës definitive të kandidatëve, me nr.2969, i datës 28.08.2019; Kontrata për punë praktike në kohë të caktuar me nr.3181, e datës 11.09.2019; e lidhur në mes të NPK Trafiku Urban dhe L.B, Shpallja e konkursit publik në gazetën Epoka e re. Dhe rrjedhimisht të vetmet prova materiale që ndërlidhen me veprimet e të akuzuarit R.B, janë komunikimet në Whats app; draft vendimi për shkarkimin e zyrtarit; raporti i ekzaminimit të telefonit t pandehurit, por, që të gjitha këto prova të analizuara një nga një si

dhe në lidhmëri me njëra tjetrën, përfshirë këtu edhe deklaratimet e dëshmitarëve, nuk provojnë veprën penale që i vihet në barrë të akuzuarit Konflikt i interesit.

Duke u bazuar në të gjitha këto që u cekën më lartë, gjykata, ka ardhur në përfundim, se nga provat e administruara e të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në parimin in dubio pro reo, nuk u vërtetua teza e akuzës se i akuzuari ka kryer veprën penale që i'u vihet në barrë.

6. Vendimi për lirimin e të akuzuarit nga akuza

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në nenin 363, paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së, Gjykata e liroi nga akuza të akuzuarin R.B, për veprën penale, siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

7. Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil

Konform dispozitave ligjore të nenit 462 par.1 dhe 3 të KPPRK-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në arsyet që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.989/20

Datë:20.11.2023

Zyrtarja ligjore
Tringë Zogaj

Kryetarja e trupit gjykues,
Fatime Dërmaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.